



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Sisteme Informacioni në Ekonomi”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Dr. Thoma KORINI

2. Dr. Irma SHYLE

Mars 2023

Për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” ofruar nga Universiteti i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 510, datë 08.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH 297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohe të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	31 PAE/81 PAK v.a. 2021-2022 31 PAE/ 76 PAK v.a. 2020-2021 25 PAE/ 89 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	58 Studentë v.a. 2021-2022 52 Studentë v.a. 2020-2021 50 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

17. 

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Universiteti i Tiranës (UT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.207 dt.30.05.1957. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022.

Universiteti i Tiranës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute emërtuar si vijon:


- Filiali i Sarandës
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Instituti i Fizikës Bërthamore
- Instituti i Studimeve Europiane

Statuti i UT, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është miratuar në vitin 2018.

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” është hapur me Urdhër Nr.510, datë 8.11.2010 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në "Sisteme informacioni në ekonomi". Forma e regjistrimit të diplomës është kryer me Urdhër Nr.297, datë 20. 07. 2012 të MASH. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Statistikës dhe Informatikë e Zbatuar, njësi përbërëse e Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin European të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Objektivi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” është realizimi i formimit shkencor dhe profesional të specialistëve për zgjidhjen e problemeve ekonomike duke identifikuar, analizuar, zhvilluar dhe implementuar zgjidhje bazuar në sistemet e informacionit si dhe zhvillimi i aftësive mbi planifikimin analitik, strategjik e kërkimor dhe menaxhimin e projekteve.

UT ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” më datë 26.10.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin për herë të para të këtij programi studimi.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; (rreth 200 fjalë)


Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit. Raporti i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që IAL ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin objektivisht performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.Dr Thoma Korini dhe Dr Irma Shyle. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Muhamed Prezja, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimit. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin Ekonomik të zhvilluar në datat **5 dhe 6 Tetor 2022** sipas një agjende të hartuar nga GVJ me asistencën e ASCAL.



Më datë 10.02.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.1/26 prot, datë 10.02.2023 dërgohet në Institucion Draft-Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 28.02.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr.10/7 Prot, datë 02.03.2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

GVJ në FUSHA II – Standardi II.3 - Kriteri 6 - Fq.31: “Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në IAL, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikën, dhe seminarët. Për syllabuset dhe praktikën respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Për praktikën profesionale, DSIZ nuk ka hartuar një program (syllabus) dhe udhëzime specifike për këtë program studimi. Përdoren vetëm formularët e miratuar në FE dhe që përdoren për të gjithë programet Master të ofruara nga FE.

GVJ, sygjeron që departamenti të përgatisë programin e praktikës profesionale, si edhe udhëzues për praktikën. Kjo do të ndihmojë studentët për të qenë më të qartë dhe të orientuar.”

Komente nga GVB: Në përmbushje të Kriterit 6 të Standardit II.3, evidentojmë që programi i studimit MSHSIE përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë (Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite), informacionin për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara (Evidenca 10.3 - Plani mesimor MSHSIE_21_22).

Përsa i përket përgatitjes së programit të praktikës profesionale, të sugjeruar nga GVJ, qartësojmë që fakulteti përdor formatet e miraturara, të cilat janë të publikuara në faqen e *web-it* <https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet> dhe janë standarde për të gjitha programet e studimit. Çdo student ka pedagogun udhëheqës të praktikës, i cili e mbikqyr gjatë gjithë zhvillimit të saj dhe e udhëzon specifikisht në varësi të programit të studimit për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, raportit përfundimtar dhe në lidhje me procesin e mbrojtjes së praktikës në përfundim të saj. Sugjerimin e GVJ e marrim në konsideratë, por mendojmë që në këtë Standard, plotësimi i Kriterit 6 nuk është çenuar.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, sikurse GVJ ka përmendur dhe ka sygjëruar, duhet të ketë një program (syllabus) të detajuar për praktikën profesionale, për aq kohë sa praktika profesionale ka një numër kreditesh të përcaktuar. Pra sikurse çdo lëndë në këtë program studimi ka një program (syllabus), edhe praktika profesionale duket të ketë një syllabus ku të përcaktohen tema konkrete që e udhëzojnë studentin për ti parë në mënyrë praktike në kompaninë/institucionin ku do të zhvillojë këtë praktikë.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk e ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.6 - Kriteri 1 - Fq.37-38: “GVJ është shprehur edhe më sipër se përsa i përket angazhimit me tregun e punës, Së pari, një pjesë e mirë e të diplomuarve në programin e studimit janë të punësuar dhe një pjesë e mirë kur regjistrohen janë të punësuar. Kjo

është një pikë shumë e fortë e programit. Megjithatë, dokumenti i tregut të punës, si u analizua edhe më sipër, na ofron një përmbledhje të disa kërkrimeve të stafit të angazhuar në programin e studimit në drejtim të zgjedhjes së universitetit por jo një identifikim i mirëfilltë i aftësive dhe kompetencave të nevojitura. Po kështu nuk gjetëm evidenca të plota për angazhimin e partnerëve të tregut të punës në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit. GVJ thekson që ka komunikime midis palëve por mungon një një proces i strukturuar në këtë drejtim prandaj duhet adresuar.”

Komente nga GVB: Në lidhje me plotësimin e Kriterit 1 të Standardit II.6, evidentojmë që DSIZ ka bashkëpunime të drejtpërdrejta (evidencat e poshtëshënuara) me institucione në vend, publike dhe private, në të cilat studentët e këtij programi zhvillojnë praktikat mësimore dhe ku pothuaj të gjithë studentët janë të punësuar. Ky bashkëpunim i ndërsjelltë ka bërë të mundur që kurrikula e këtij programi studimi të jetë sa më afër nevojave të tregut të punës, dhe si rezultat ka sjellë edhe suksesin në punësim të të gjithë studentëve, jo vetëm atyre të diplomuar, por edhe atyre që sapa kanë filluar studimet në këtë program.

E shohim shumë me vend sugjerimin e GVJ për të evidentuar më mirë në të ardhmen në Raportin Vjetor të departamentit ndikimin dhe rezultatet që ky bashkëpunim sjell në përmirësimin e përmbajtjes së programit.

Evidenca 17 - Studimi i tregut te punes_final.

Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022

Evidenca 34.1 - Marreveshje bashkepunimi kulturor me Qeverine italiane

Evidenca 34.2 - Anëtarësimi në NISPA

Evidenca 34.3 - Marreveshjet e FEUT

Evidenca 34.4 - Marreveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023

Komente nga GVJ: GVJ ka analizuar dokumentacionin e vënë në dispozicion në lidhje me këtë kriter pra për analizën e tregut për këtë program studimi si edhe propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk e ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.1 - Kriteri 4 - Fq.43: “Bazuar në të dhënat e siguruar nga këto vlerësime, NJSBC - si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, ku përfshihen dhe rezultati i punës së personelit ndihmës akademik - harton raportin vjetor me anë të të cilit informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UT rreth rezultateve të monitorimeve, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Megjithatë struktura e sapokrijuar ka ende mangësi në përmbushjen e të gjitha hapave të kriterit dhe ato zbatohen në nivel institucional dhe jo në nivelin e departamenti. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë njësi u tha se po punohet për të institucionalizuar të gjitha

procedurat që lidhen me garantimin e cilësisë në të gjitha komponentët e programit të studimit. Hartimi i një plani pune nga ana e NJSBC-së dëshmon vullnetin e strukturave drejtuese në IAL për të përmirësuar këto procese.”

Komente nga GVB: Përsa i përket Kriterit 4 të Standardit III.1, theksojmë se NJSBC, si struktura e ngritur për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në FE, i bën publike rezultatet e vlerësimit të marra nga pyetsorët (Dokumentat shtesë: 6.0-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pytesorëve të studentëve-MSHSIE-FEUT). Në këtë kuadër mund të themi se përmbushja e këtij kriteri nuk është cënuar. Biem dakord që kjo strukturë është e re dhe ka akoma vend për përmirësime në përmbushjen e detyrave të saj dhe sugjerimin e GVJ e shohim me vend, për përmirësimin e këtij procesi në të ardhmen.

Evidenca 6.0 (Dok. Shtesë) - Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pytesoreve te studenteve MSHSIE-FEUT

Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise

Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.

Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC.

Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave

Komente nga GVJ: GVJ bazuar në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion, evidenton se raporti vjetor për realizimin dhe përpunimin e të dhënave bëhet në nivel departamenti.

Komenti merret parasysh dhe GVJ e ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.2 - Kriteri 5 - Fq.45-46: “FEUT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetëtori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatit e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Megjithatë procesi se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit nuk është e qartë. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e NJSBC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se struktura aktuale e NJSBC funksionon më shumë në nivel institucioni se në nivelin e njësisë bazë duke qenë se është një strukturë relativisht e re. Megjithatë si u përmend edhe më lart, hartimi i një plani nga IAL për aktivitetin monitorues të komponentëve të ndryshëm të programit të studimit përbën një hap pozitiv.”

Komente nga GVB: Përsa i përket vlerësimit dhe përmirësimin të metodave të mësimdhënies, sikurse është evidentuar edhe në këtë raport, Fakulteti i Ekonomisë ka angazhuar një strukturë të posaçme sipas akteve ligjore në fuqi, që është NJSBC. Ajo operon në përputhje me Manualin e Sigurimit të Cilësisë në UT, dhe ka një plan të hartuar dhe miratuar nga Kryetari i saj në FE. Në fund të çdo semestri studentët vlerësojnë procesin mësimor në tërësi, dhe mendimet e tyre

pasqyrohen në raportin e NJSBC. Pra në kuadër të përmbushjes së Kriterit 5 të Standardit III.2, përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë është e garantuar. Në këtë kuadër mund të themi që ky kriter është përmbushur. Sikurse është cilësuar nga GVJ kjo strukturë është e re, dhe operon në nivel institucional, dhe ka vend për përmirësime në strategjinë e operimit të saj. Megjithatë theksojmë që përveç punës së NJSBC, një rol të rëndësishëm në përmirësimin e metodave të mësimdhënies ka vetë departamenti dhe pedagogët, të cilët nëpërmjet mbledhjeve periodike sjellin në vëmendje sugjerimet e studentëve, si dhe eksperiencat e tyre dhe njohuritë e fituara nga trajnimet e zhvilluara në këtë kuadër.

Evidenca 39 - Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë

Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit të cilësisë

Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.

Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë NJSBC.

Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave

Komente nga GVJ: GVJ e bazon evidentimin e tij për këtë kriter bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni. Pyetëtori i studentëve është finalizuar vetëm me një raport për të dhënat e sigurura prej pyetësorit por nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me sygjerimet, përmirësimet apo ndryshimet që duhet të realizohen bazuar në këto të dhëna duke patur në fokus vlerësimin dhe sygjerimet e studentëve.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk e ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.2 - Kriteri 6 - Fq. 46: “Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nëpërmjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive.

GVJ sugjeron që në fokus të vazhdueshëm duhet të mbahet përmirësimi i kurrikulave me informacione sa më të azhornuara duke patur parasysh se në teknologjinë e informacionit, literatura dhe kërkimi janë në evolucion të vazhdueshëm duke pasur parasysh zhvillimet në Inteligjencën artificiale dhe Digital Marketing.”

Komente nga GVB: Përsa i përket përmbushjes së Kriterit 6 të Standardit III.2, sikurse edhe GVJ e evidenton, zhvillimi i mësimin është interaktiv, dhe niveli i mësimdhënies është shumë i lartë. Kjo falë nivelit të lartë të kualifikimit të stafit akademik (Evidenca 20 - CV_PEA_PAK), si dhe trajnimeve të vazhdueshme që FE organizon për stafin e ri, në lidhje me përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies (Evidenca 39 - Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë). Në këtë kuadër mund të themi se ky kriter është përmbushur. E vlerësojmë sugjerimin e GVJ për përmirësimin e kurrikulës, të cilin ne e shohim si një proces të vazhduar, jo specifikisht të lidhur me këtë kriter, por për të rritur nivelin akademik të programit dhe për të ofruar një diplomë në përputhje me kërkesat e tregut. Përsa i përket sugjerimeve

specifike sjellim në vëmendje se MSHSIE është një program studimi që ka në fokus ndërtimin e sistemeve informatike dhe inteligjente, gjë që pasqyrohet më së miri në kurrikulën dhe planin mësimor të programit (Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tabela 10); ku pjesë e programit janë lëndë të rëndësishme si Inteligenca Artificiale, Programim i Avancuar në Web, Aplikime Mobile, Analizë dhe Projektim i Sistemeve të Informacionit, etj. Produktet e tyre krijojnë mundësinë e zhvillimit të platformave dixhitale në shërbim të fushave të ndryshme të Ekonomisë, sikurse dhe të Marketingut Dixhital i cili është një formë marketingu ku bizneset promovojnë produktet dhe shërbimet e tyre përmes platformave dixhitale.

Evidenca 39 - Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë

Evidenca 20 - CV_PEA_PAK

Evidenca - Aneks tabelat përmbledhëse, tabela 10.

Komente nga GVJ: GVJ e ka konsideruar të përmbushur këtë kriter dhe thjesht ka dhënë një sygjërim për përmirësimin dhe adaptimin e kurrikulave me ndryshimet teknologjike.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk e ndryshon vlerësimin – pasi është sygjërim

GVJ në FUSHA III – Standardi III.4 - Kriteri 1 - Fq. 50-51: “Strukturat e ngritura në nivel institucional merren me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë dhe drejtohen nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSC), i cili bashkërendon punën me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e kurrikulave dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Këto zyra janë përgjegjëse për hartimin e planeve dhe aktiviteteve të monitorimit, në lidhje me syllabuset e lëndëve, dokumentacionit për programet e studimit etj. Vihet re dhe nga lista e evidencave që IAL ka vënë në dispozicion se ka një qasje proaktive në këtë drejtim. Plani i veprimit për sigurimin e cilësisë e tregon më së miri këtë tendencë. Stafi i angazhuar në NJSBC në nivel fakulteti pohoi që është një strukturë në zhvillim e sipër dhe se po bëhen të gjitha përpjekjet për ta ngritur atë sipas të gjitha standarteve të kërkuara për përmirësimin e cilësisë duke përdorur edhe eksperiencën nga IAL të tjera.

GVJ rekomandon shtrirjen e proaktivitetit edhe në njësinë bazë që është përgjegjëse për programin e studimit.”

Komente nga GVB: Në lidhje me përmbushjen e Kriterit 1 të Standardit III.4, theksojmë se FE ka ngritur strukturat e posacme në përputhje me kërkesat e ligjit, për promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit që ofrohen në këtë institucion. Sikurse GVJ ka evidentuar, NJSBC është një strukturë e re, e cila funksionon në nivel të njësisë kryesore. Puna e saj është në përmirësim të vazhdueshëm. Duke e vlerësuar rekomandimin e GVJ si të vlefshëm, duam të theksojmë se pavarësisht se nuk ka struktura të tilla në nivel të njësisë bazë, përsëri promovimi dhe përmirësimi i cilësisë në mësimdhënie, është një fokus kryesor gjatë mbledhjeve të departamentit, në analizën vjetore të programit të studimit, në mardhënien midis lektorëve dhe asistentë pedagogëve, etj.

Evidenca 4.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 9

Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC

Evidenca 08.1 - Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)

Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë

Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise

Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.

Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT

Komente nga GVJ: GVJ e ka sqaruar këtë rekomandim në RVJ.

Komenti nuk merret parasyh dhe GVJ nuk e ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.4 - Kriteri 4 - Fq. 52: “Stafi akademik i angazhuar në përgatitjen e programit të studimit kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik në zbatim edhe të direktivave dhe rekomandimeve të paraqitura në Planin Shkencor të UT 2018-2022. Në këtë aspekt, stafi akademik i programit të studimit ka kryer më shumë aktivitete duke përfutur edhe nga projekte në të cilat është pjesë. Një metodologji e plotë se si zhvillohen konkretisht aktivitetet për trainimin e stafit, si evidentohen nevojat apo si zbatohen programet e trainimit nuk është ende i integruar në aktivitetin e DSIZ megjithatë kjo procedurë është prezente për pedagoget e rinj, e theksuar kjo edhe gjatë takimit që GVJ pati me Dekanin e Fakultetit.”

Komente nga GVB: Në lidhje me Kriterin 4 të Standardit III.4, sikurse edhe GVJ evidenton, theksojmë që institucioni ka zhvilluar trajnime në fushën e pedagogjisë dhe metodave të mësimdhënies për stafin e ri akademik. Një trajnim i tillë u organizua në Korrik të 2022 nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në kuadrin e zhvillimit të burimeve njerëzore në Universitetin e Tiranës (<https://feut.edu.al/lajmerime/1636-perfundon-trajnimi-i-48-pedagogeve-te-rinj-tefakultetit-te-ekonomise>). Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve trajnuese bazohet mbi dokumentat themelore të institucionit, siç janë “Strategjia e UT”, “Strategjia-e-zhvillimit-UT2018-2023” dhe “Strategjia për planin institucional për mësimdhënie në UT”.

Evidenca 39 - Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë <https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/>

Evidenca 3 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023

Evidenca 3.0 - Strategjia e UT

Evidenca 3.1 - Strategjia per planin institucional per mesimdhenie ne UT

Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor.

Komente nga GVJ: GVJ e gjykon të drejtë këtë koment.

Komenti merret parasyh dhe GVJ e ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.4 - Kriteri 6 - Fq. 52: “Personeli akademik që është përgjegjës për zbatimin dhe cilësinë e mësimdhënies merr një ndihmë të vazhdueshme nga personeli ndihmës akademik për sigurimin e një procesi cilësor të mësimdhënies por edhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe përmirësimin e syllabuseve, literaturës, si edhe të gjithë elementëve të tjerë të parashikuar në procesin e mësimdhënies. IAL ka tashmë një metodologji dhe procedurë të plotë se si bëhet azhurnimi i programit të studimit por jo në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies.”

Komente nga GVB: Në përmbushje të Kriterit 6 të Standardit III.4, theksojmë se një nga pikat më të forta të programit të studimit MSHSIE, është stafi i kualifikuar akademik dhe ndihmës akademik i cili është i angazhuar maksimalisht në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor në tërësi dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Tregues të rëndësishëm në këtë kuadër janë shkëmbimet e stafit me bursat e mobilitetit Erasmus+ për mësimdhënie dhe trajnime, duke sjellë kështu eksperiencat më të mira nga universitetet perëndimore. Gjithashtu një tregues tjetër i rëndësishëm është përditësimi i vazhdueshëm çdo vit akademik i literaturës së përdorur në lëndët e programit (Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit). Tregues i angazhimit të tyre në kuadër të përmirësimit të programit janë dhe propozimet që kanë sjellë për ndryshimin e lëndëve ndër vite, propozime të cilat janë diskutuar në departament dhe më pas janë miratuar në Dekanat (Ndryshimet në Planet Mësimore sipas sipas VKMs -Tabela 11). Përsa i përket sugjerimit të GVJ për hartimin e një metodologjie në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, theksojmë se dokumenti mbi të cilat bazohen këto ndryshime është “Strategjia për planin institucional për mësimdhënie në UT”.

Evidenca 3.1 - Strategjia për planin institucional për mësimdhënie në UT

Evidenca 45 - Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit

Evidenca 07 - Rregulloret e Programit të Studimit MSHSIE.


Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.

Evidenca 52 - Ndryshimet në Planet mësimore sipas sipas VKMs -Tabela 11.

Komente nga GVJ: GVJ bazuar ndër të tjera edhe në evidencën 3.1. Strategjia për planin institucional për mësimdhënie në UT, evidenton përmbushjen e këtij kriteri.

Komenti merret parasysh dhe GVJ e ndryshon vlerësimin.

Vlerësimi i standartit III.4 ndryshon nga kryesisht në përmbushet plotësisht.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi L1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” i ofruar nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar në Fakultetin e Ekonomisë (FE), në Universitetin e Tiranës (UT), përmban lëndë dhe kurrikula të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. Ky program është hartuar duke marrë parasysh traditën e IAL-së, nevojat e tregut të punës si dhe ecurinë e proceve zhvillimore të vendit. Programi synon pajisjen me kompetenca dhe aftësi të nevojshme në sistemet e informacionit dhe në përdorimin e teknologjisë për zgjidhjen e problemeve të biznesit si edhe proceset sipërmarrëse që lidhen me të dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kombëtare.</p> <p>Sikurse edhe në objektivat e programit të studimit programi i studimit është në përputhje me misionin dhe vizionin e Institucionit dhe në përputhje me interesat kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE, neni 4</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” është pjesë e programeve të studimit të ciklit të dytë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Nr.510, datë 08.11.2010 për hapjen e programeve të studimit “Master i Shkencave në Universitetin e Tiranës” (<i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE, neni 3</i>).</p> <p>Programi i studimeve Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. Ky program studimi ka për qëllim t’u ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e teknologjisë së Informacionit dhe biznesit. Ky</p>

	<p>program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për t'i ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e teknologjisë në biznes.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Rregullorja e programit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” (<i>Evidenca 07-Rregullore e programit te studimit_MSHSIE</i>) është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM 41/2018 për elementët e studimit, në udhëzimet 15 dhe 31 të MAS, në Kodin e Cilësisë të Universitetit të Tiranës” (<i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë</i>), si edhe në Statutin (<i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i>) dhe Rregulloren e Universitetit (<i>05 - Projekt Rregullorja UT FINAL</i>) dhe në Planin Strategjik të Departamentit Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. (<i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ.</i>)</p> <p>Në këtë mënyrë programi i studimit i rregulluar nga kjo rregullore ofrohet në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë së tij të përcaktuara në statutin e tij. GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e Universitetit të Tiranës ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua edhe gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik, në ditët e vizitave në institucion. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të plotë me sa më sipër dhe ofron mundësinë që studentët të ndjekin studimet e tyre duke rritur mundësitë për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Ky program studimi ka për qëllim t'u ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e teknologjisë së Informacionit dhe biznesit. Ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e teknologjisë në biznes.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në një departament i cili ka mundësi potenciale në reflektimin e nevojave të tregut sa i përket ndërthurjes</p>

	<p>së aftësive të teknologjisë së informacionit në biznes. GVJ vlerëson ndërthurjen e teknologjisë së informacionit me njohuritë në biznes në një program të vetëm studimi. Pasi multidisiplinariteti është një nevojë e kohës jo vetëm në Shqipëri por edhe në tregun rajonal dhe global.</p> <p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE</i></p>		
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Ky program studimi u ofron studentëve kompetenca në përdorimin e teknologjisë së informacionit në biznes, në dhënies e zgjidhjes të problemeve në biznes, duke identifikuar, analizuar, zhvilluar dhe implementuar metoda dhe procedura duke u bazuar tek teknologjia e informacionit sikurse edhe duke mundësuar përvetësimin e kompetencave dhe aftësive shkencore për vazhdimësinë e studimeve të thelluara në ciklin e tretë të studimeve. Programi Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” gjithashtu garanton formimin dhe aftësimin e studentit për kërkimin shkencor pasi në përbërje të kurrikulës ka lëndë specifike për metodat e kërkimit dhe një numërr i konsiderueshëm kreditesh i alokohen punës së studentit, e cila fokusohet tek tema e masterit e udhëhequr nga një ekspert i fushës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT si dhe Planin Strategjik (2018 – 2023), programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me të dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin institucional të UT-së. Kjo reflektohet edhe nga kërkesa në rritje për të ndjekur studimet në Masterin e shkencave në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, si dhe një trend pozitiv në mesataren e studentëve që zgjedhin këtë program studimi (nga 7.73 në 8.11).</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

Faqe 14



	<p>Një nga objektivat e institucionit (UT) është ruajtja dhe avancimi i profilit të tij. Ky program studimi është në përputhje me këtë objektiv dhe e çon përpara atë, dhe GVJ e vlerëson pozitivisht faktin që në strategjitë e zhvillimit të Departamentit por edhe në planin strategjik të vet programit të studimit, paraqitet si nevojë pasja në konsideratë të vazhdueshme e ndryshimeve ekonomike, sociale dhe teknologjike që influencojnë direkt nevojat për kompetenca të reja në tregun e punës. Megjithatë, ashtu si paraqitet nga vet IAL, <i>stafi është i mbingarkuar me orë mësimore dhe kjo ul kohën në dispozicion të kërkimit dhe ndërkombëtarizimit.</i></p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e përgjithshme të IAL-së si edhe atë të njësisë kryesore e njësisë bazë. Bazuar në planin e zhvillimit të FE por edhe DSIZ, programi i studimit synon të formojë kërkues të rinj të cilët janë të orientuar drejt aktiviteteve akademike dhe kërkimore. Programi është reflektim i prioritetëve të shkruara në statutin e UT dhe rregulloren e DSIZ.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit MSHSIE</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation.</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” është i përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të dytë si nga forma, përmbajtja ashtu dhe shtrirja kohore. Ky program studimi ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (4 semestra) dhe emërtimi i tij është i përshtatshëm sa i përket komunikimit të tij të studentët e synuar. Ky program është në përputhje dhe vazhdimësi me një nga fushat e drejtimit akademik të institucionit, atë të Informatikës Ekonomike. Kjo konfirmohet edhe nga profili i studentëve që zgjedhin këtë master. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë program studimi, u konstatua që studentët që ndjekin programin e</p>

17.




	<p>studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Informatikë Ekonomike.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit _MSHSIE</i></p>						
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me prioritetet kombëtare e rajonale për zhvillim e kurrikulave, ndërkombëtarizimin dhe përvetësimi i praktikave të mira evropiane dhe atyre globale të kurrikulës janë vendosur si objektiva strategjike si për DSIZ ashtu dhe ato që lidhen direkt me këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit _MSHSIE</i></p>						
<p>Shkallia e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, janë të përcaktuara qartë objektivat formuese të cilat synojnë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të diplomuarit do të jenë të aftë të planifikojnë, drejtojnë, organizojnë dhe marrin pjesë në grupe pune dhe projekte në grup që mundësojnë arritjen e zgjidhjeve të suksesshme të sistemeve të informacionit brenda organizatës; • Të diplomuarit do të mund të fitojnë aftësitë për të komunikuar dhe bashkëpunuar me persona në role të ndryshme të sistemeve të informacionit si përdorues, menaxherë, zhvillues, analistë dhe administratorë rrjeti/baze të dhënash;


17.



	<ul style="list-style-type: none"> • Të diplomuarit do të fitojnë mundësinë për të kuptuar funksionet dhe aplikimet e kompjuterave në mjedisin e sistemeve të informacionit dhe të aplikojnë këtë kuptueshmëri brenda organizatës dhe strukturave dhe proceseve të biznesit; • Të diplomuarit do të mund të arrijnë të zgjidhin probleme ekonomike duke identifikuar, analizuar, zhvilluar dhe implementuar zgjidhje bazuar në sistemet e informacionit; • Të diplomuarit do të fitojnë aftësinë për të mirëmbajtur njohuritë aktuale të metodologjive dhe teknologjive të sistemeve të reja të informacionit për të adresuar nevojat kritike të biznesit në lidhje me kërkesat, qëllimet strategjike dhe veprimet e përditshme; • Të diplomuarit do të mund të tregojnë aftësinë për të kuptuar dhe aplikuar konsiderata etike ndaj problemeve të ndryshme, si dhe praktikat e mira të sigurisë së informacionit në mjedisin e sistemeve; • Të diplomuarit do të mund të zhvillojnë aftësitë mbi planifikimin analitik, strategjik e kërkimor dhe menaxhimin e projekteve. <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE, neni 4 Misioni dhe Qëllimet</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim tregu për të gjitha programet e studimit të ofruara duke parë diplomimin apo jo si edhe diplomimin në përputhje me diplomën për të diplomuarit në periudhën 2014-2017. Institucioni disponon të dhëna të analizuara dhe konkluzione konkrete të një studimi të tregut në përgjithësi.</p> <p>Bazuar edhe në RVB, GVJ, evidentoi se Institucioni është në proces të analizimit dhe përpunimit të të dhënave për vitin 2022. GVJ, gjatë vizitës në Institucion, në takim me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Drejtuesin e Departamentit, stafin si edhe studentët, u informua se punësimi i të diplomuarve në MSc në Sistemet e Informacionit në Ekonomi është 100%.</p> <p><i>Evidenca 17. Studime të tregut të punës -Final</i> <i>Evidenca RVB_Shqip.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar mbi programin e studimit, rezulton se qëllimi i këtij programi studimi është të formojë</p>

<p>prishme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>profesionistë në fushën e sistemeve të informacionit, të aftë të integrojnë zgjidhjet që ofron teknologjia e informacionit me ato të proceseve të biznesit për të plotësuar nevojat për menaxhimin e informacionit apo të të dhënave për sipërmarrjet, por jo vetëm, duke u mundësuar atyre arritjen e objektivave të tyre në një mënyrë efektive dhe efçiente. Programi i studimit zhvillohet në dy vite. Në vitin e parë të diplomuarit realizojnë 65 kredite të shpërndara në 10 lëndë. Në vitin e dytë, studentët pajisen me 55 kredite, nga këto, 30 kredite janë të alokuara në praktikën profesionale (12ETC) dhe Mikrotezë (18 ETC). Sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, 80-2015, neni 70, pika 2: Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.</p> <p>GVI, bazuar në kuptimin e ligjit, rekomandon rishpërndarjen e krediteve në 2 vitet e studimit, në përputhje me ligjin.</p> <p>Lëndët bazë të cilat kanë për objektiva të përgatisin studentët nga ana metodologjike përbëjnë 5.8% të krediteve të programit të studimit dhe ky komponent mësimor është në përputhje me VKM nr 41-datë 24.1.2018.</p> <p>Lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse janë konform VKM nr 41.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit - në strukturë, organizim dhe përmbajtje – është i krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara në IAL në shtete të tjera të Bashkimit Evropian (psh Gjermania) dhe më gjerë. Për më tepër programi i studimit ofrohet me ECTS dhe në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e zonës evropiane të arsimit të lartë. IAL ka paraqitur të uniformizuar përmbajtjen e lëndëve në përputhje me VKM nr 41 dhe janë bërë përpjekje për të përditësuar literaturën e cila është në ndryshim të vazhdueshëm duke pasur parasysh fushën që mbulon programi i studimit.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveqare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit nuk ka lidhje me profesionet e rregulluara dhe ndjek udhëzimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë të cilat, në shumicën e rasteve, janë të inkuorpuara në legjislacionin vendas për arsyet që janë përmendur më sipër si psh transferimi i studimeve.</p>

17



	<p>Programi i studimit Msc në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE. Programi është në përputhje me kërkesat e Bolonjës dhe suplementi i diplomës bazohet në modelin e hartuar nga Këshilli Europian.</p> <p><i>Evidenca 15.1 - Modeli i Diplomës (Urdhëri i Aprovimit)</i> <i>Evidenca 15.3 - Model Suplement Diplome_MSHSIE_2022.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në programin e studimit parashikohet praktikë profesionale e cila përbën 10% (12 ECTS) të programit të studimit, në përputhje me legjislacion në fuqi. Në këtë kuadër, FE/DSIZ mbështet studentët duke ofruar një listë institucionesh partnere për realizimin e praktikave.</p> <p>Nga takimi me studentët rezultoi se praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte të ndryshme, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Gjithashtu studentët që punojnë e zhvillojnë praktikën në vendin e tyre të punës. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte private apo publike në funksion të objektivave të këtij programi dhe nën drejtimin e personelit akademik të caktuar për këtë qëllim.</p> <p>Në fund të praktikës studentët plotësojnë një dokument më të gjitha veprimtaritë që ata kanë realizuar dhe marrin vlerësimin përkatës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 34.4 - Marreveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Informacionit në Ekonomi" ofrohet në gjuhën shqipe. Megjithatë në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe transferimit të studimeve, njësia bazë ka vënë në dispozicion të palëve të interesuara syllabuset e lëndëve edhe në gjuhën angleze. Programet mësimore në anglisht i shërbejnë studentëve në rast transferimi studimesh jashtë shtetit. Po kështu nga konsultimi i CV-ve të stafit të angazhuar në programin e studimit, vihet re një potencial i konsiderueshëm për ta ofruar këtë program studimi në gjuhën angleze. Ofrimi i programit në gjuhën angleze i krijon mundësinë studentëve që e ndjekin atë të punësohen me lehtësi në institucione vendase, por edhe të huaja të cilat operojnë në fushën e teknologjisë të informacionit. Në raportin e vlerësimit të brendshëm, paraqitet që Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Tiranës (FEUT) iu ofron mundësinë studentëve të</p>

	<p>ciklit të parë të zgjedhin për ti zhvilluar studimet në gjuhën angleze ose shqipe dhe DSIZ është duke menduar për ta shtrirë këtë praktikë edhe në programet e studimit të ciklit të dytë. Gjithashtu bazuar tek RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik si edhe Drejtuesin e Departamentit u evidentua që disa lëndë të këtij programi studimi ofrohen në anglisht (Modelim në biznes, Inteligjencë artificiale, Seminar special në ekonomi)</p> <p><i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023.</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i> <i>Evidenca 20 - CV_PEA_PAK.</i> <i>Evidenca 22 - CV_PNA</i> <i>Evidenca RVB_Shqip.pdf</i></p>								
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Dokumentacioni për këtë program studimi është në gjuhën shqipe ashtu sikurse ofrohet. Dokumentacioni që ka lidhje me ndërkombëtarizimin – aplikime, leksione të përbashkëta, etj. – është në gjuhën angleze.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.4 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>IAL, FEUT ka një përvojë të gjatë mbi 65 vjeçare në ofrimin e studimeve universitare në fushën e ekonomisë, financës, kontabilitetit, menaxhimit dhe marketingut. IAL ka krijuar struktura ndihmëse, këshilluese, monitoruese (KSBC) për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ndërkohë, programi i studimit Master i Shkencave në SIE organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS) i cili përbëhet nga 3 anëtarë të zgjedhur nga përgjegjësi i departamentit. Drejtuesi i KPS është gjithashtu dhe koordinatori i programit të studimit. GVJ e vlerëson pozitivisht praninë e koordinatorit të programit të studimit i cili përfaqëson një person të dedikuar që bashkëpunon dhe koordinon të gjitha aktivitetet që lidhen me programin e studimit me strukturat e tjera përgjegjëse.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 20

	<p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE (neni 6, neni 7)</i></p> <p><i>Evidenca 20 - CV_PEA_PAK.</i></p> <p><i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise</i></p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë</i></p> <p><i>Evidenca Tabela 6 - Të dhëna për Personelin Akademik MSHSIE</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të FEUT. Ofrimi i programit të studimit është tërësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore. Gjithashtu, ky program është në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, me Statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UT-së.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i></p> <p><i>Evidenca 23.1 - Staf i Akademik FEUT me kohë të plotë 28.02.2022.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Gjithashtu fusha e përgjithshme është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të DSIZ, i cili është përgjegjës për programin e studimit. Ky program studimi i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe bazohet në standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidenca 23.2 - Tabela 2 - Të dhëna për stafin akademik të DSIZ.</i></p> <p><i>Evidenca 24 - Tabela 6 - Të dhëna për Personelin Akademik MSHSIE</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga pikëpamja rregullatore, UT ka miratuar statutin e tij ku sanksionohen njësitë ndihmëse pranë rektoratit si</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Struktura e programeve mësimore dhe e sigurimit të cilësisë ✓ Struktura e marrëdhënieve me jashtë dhe studentët ✓ Struktura e kërkimit shkencor dhe IT-së ✓ Struktura juridike dhe e marrëdhënieve me publikun ✓ Struktura e burimeve njerëzore dhe protokollit <p>Si edhe pozicioni i njësisë kryesore njësisë bazë, grupet mësimore kërkimore brenda dhe midis departamenteve etj. Gjithashtu, në bashkëpunim me rektoratin e UT, FE ka vënë në jetë procedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë të cilat janë në institucionalizim e sipër (Neni 12,14,19, 42,46,47 Statuti UT).</p> <p>Po kështu, secili prej pedagogëve të angazhuar në programin e studimit në fund të vitit akademik plotëson formularin për aktivitetin akademik dhe profesional dhe dorëzon një plan për vitin e ri. Ky dokumentacion përbën bazën e vlerësimit të punës, ndarjes së detyrave dhe planifikimit të veprimtarive.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 05 - Projekt Rregullorja UT FINAL.</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditësuar 2016.</i> <i>Evidenca 05.2 - vendim-4-1-Rregullore-e-brendshme-e-punes.</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation</i> <i>Evidenca 06.1 - Projekt rregullore e njësisë bazë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>FEUT ka bashkëpunime me institucione/kompani publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e ekonomisë, financave, menaxhimit marketingut etj. Organizatat/institucionet, i përkasin sektorit publik, privat, sektorit financiar etj.</p> <p>Përsa i përket marrëdhënieve me jashtë, UT, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus Mobility me rreth 40 Universitete në BE si dhe jashtë saj.</p> <p><i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 34.3 - Marrëveshjet e FEUT.</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit.</i> <i>Evidenca 43.6 - Mobilitetet e studenteve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan</p>	<p>Siç është përmendur me sipër, institucioni ka bashkëpunime të strukturuar me institucione publike qendrore kryesisht për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 22

<p>marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>zbatimin e praktikave studentore por edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Një tjetër element që e lehtëson, punën e institucionit, është se shumica e studentëve të programit janë të punësuar, para se të regjistrohen në program. Bazuar në dokumentacion por edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i mirë organizuar dhe funksional.</p> <p><i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 34.3 - Marrëveshjet e FEUT.</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi ndërmjet Universiteti të Tiranës dhe bizneseve për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi, bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të veçanta. GVJ, gjatë takimit që pati me stafin akademik por edhe me studentët e këtij program studimi, evidentoi se institucionet/bizneset ku studentët kryejnë praktikën janë të lidhur me fushën e studimit.</p> <p><i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 34.3 - Marrëveshjet e FEUT.</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me stafin e përfshirë në zyrën e projekteve në FEUT u evidentuan mundësitë e përfshirjes së stafit në programe dhe projekte të ndryshme kombëtare (AKKSHI) dhe ndërkombëtare, Jean Monnet, Erasmus Plus Capacity Building të cilat nuk kanë vetëm si objekt mobilitetet por edhe kërkimin shkencor. Nga konsultimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, vihet re se projektet kanë në fokus: Kërkim, Ekselencë, dhe Inovacion. Gjithashtu vlen të përmendet që IAL vë në dispozicion të stafit një guidë për thirrje të reja projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 43.3.3 - Permbledhje e projekteve FEUT Janar 2021.</i> <i>Evidenca 43.3.1 - UT_List of previous projects.</i> <i>Evidenca 43.3.4-</i> <i>Shk_Percjellese_Ermal_Haxhiaj_kthim_pergjigje_per_ëorkshope.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në institucion, u vu re se DSIZ nuk ka një praktikë të veçantë në këtë kuadër, por</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 23

<p>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>paraqet raporte të cilat evidentojnë tregues si: studenti, pedagogu udhëheqës, kompania, drejtoria apo struktura në të cilën zhvillohet praktika. Po kështu në kuadër të mobiliteteve të studentëve paraqiten informacione mbi studentët dhe universitetin e huaj ku zhvillohet mobiliteti.</p> <p><i>GVJ rekomandon pajisjen me një praktikë të raportimit të përfitimeve të studentit nga praktika profesionale në drejtim të kompetencave të reja të fituara dhe pse jo edhe evidentim të kompetencave të reja ta cilat mund ti shërbejnë si pikënisje e evolimit të tregut të punës. Raportet e praktikës që mbrohen nga studentët janë një bazë e mirë për të hartuar një analizë përmbledhëse.</i></p> <p><i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 34.3 - Marrëveshjet e FEUT.</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022</i> <i>Evidenca 43.6 - Mobilitetet e studenteve.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik inkurajohet të publikojë artikuj dhe punime shkencore me cilësi në përmbushje të kërkesave të VKM 112.</p> <p>Plani strategjik i kërkimit shkencor të UT-së shërben si një udhëzues për vendimarrjen lidhur me iniciativat institucionale, shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore sipas prioriteteve të zhvillimit të institucionit.</p> <p>UT dhe FEUT organizojnë konferenca vjetore si një mënyrë për të transferuar dhe shpërndarë rezultatet e kërkimit shkencor. Gjithashtu vetë Departamenti SIZ, organizon konferencë të përvitshme ISTI sikurse edhe ka revistën e vet në të cilat publikohen punimet e konferencës.</p> <p>Pjesëmarrja në projekte të ndryshme gjithashtu është një mënyrë për të mbështetur stafin në realizimin e kërkimit shkencor në bashkëpunim me kërkues të huaj. UT dhe FEUT në faqen e vet të</p>

	<p>web por edhe në komunikimet të ndryshme në njësitë kryesore dhe bazë vënë në dispozicion të stafit informacione mbi Thirrje Projektesh në kuadër të programit UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion 2021-2022 (https://unitir.edu.al/projekte/).</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 03. 02 Plani i kërkimit shkencor UT 2018-2020</i> https://feut.edu.al/konferenca-botime/revista-shkencore/49-ajeb https://unitir.edu.al/botime-dhe-revista-shkencore/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Rezultatet e punës kërkimore analizohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore kryesisht në fund të semestrit dhe vitit akademik. Puna kërkimore konsiderohet si pjesë e ngarkesës akademike të detyrueshme.</p> <p><i>GVJ rekomandon që raportimi i treguesve sasiorë dhe cilësorë të bëhet konform disa kritereve. Për shembull, DSIZ ka vënë në dispozicion konferencat dhe artikujt e publikuar nga stafi i angazhuar në departament dhe në programin e studimit por nuk detajohet qartë se cili është numri i artikujve i botuar në revista të Clarivate Analytics dhe Scopus si dhe numri i citimeve respektive. Këto të fundit janë tregues reale të cilësisë së publikimeve dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor dhe për rrjedhojë të personelit akademik.</i></p> <p>Rekomandimi i GVJ është edhe pjesë e Planit të Kërkimit Shkencor në UT, ku paraqiten prioritetet e kërkimit shkencor por si u tha më sipër në këtë plan strategjik duhen shprehur në mënyrë eksplicite, citimet dhe cilësia e revistave.</p> <p>Nga GVJ shihet si pozitiv që DSIZ ka vendosur si prioritet realizimin e kërkimit në funksion të syllabuseve të lëndëve që mbulon stafi i angazhuar në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 37.1 - Raporti i vjetor i kerkimit shkencor 2018-2019.</i> <i>Evidenca 43.2.3 - Puna kerkimore shkencore 2020-2021.</i> <i>Evidenca 43.3.2 - Aktivitetet shkencore DSIZ.</i> <i>Evidenca 43 - Tabela 19_20_22-Te dhena per kerkimin shkencor ne 5 vitet e fundit DSIZ.</i> <i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>FEUT përmes aktiviteteve në institucion, WEB, medias dhe medias sociale përpiqet të promovojë punën kërkimore shkencore të stafit akademik.</p> <p>Në lidhje me kriterin 4 institucioni ndjek politikën e IAL. Ndiqet statuti i UT dhe ligjet në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 02.1 - Draft-kodi i etikës UT.</i> <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Në nivel UT, Fakulteti dhe Departmenti janë një sërë aktesh që rregullojnë dhe mbrojnë pronësinë intelektuale.</p> <p>Kodi i Etikës së UT shërben për konceptimin dhe realizmin e një procesi etik të punës kërkimore dhe botuese që përfshin pedagogët dhe studentët.</p> <p>Gjithashtu, Kodi Etikës është një element që prek të gjithë veprimtarinë e procesit mësimor, nga syllabusi deri në diplomat e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 02.1 - Draft-kodi i etikës UT.</i> <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Studentët janë përfshirë në punën kërkimore dhe kanë marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga FEUT.</p> <p>Bazuar edhe tek RVB, si edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ evidentoi se një pjesë e studentëve angazhohen në konferencën shkencore të përvitshme, jo vetëm me artikuj shkencorë por edhe si anëtarë në grupin organizativ të konferencës.</p> <p><i>Evidenca 43.2.3 - Puna kerkimore shkencore 2020-2021.</i> <i>Evidenca 43.3.2 - Aktivitetet shkencore DSIZ.</i> <i>Evidenca 43 - Tabela 19_20_22-Te dhena per kerkimin shkencor ne 5 vitet e fundit DSIZ.</i> <i>Evidenca nr 3.0 (dokumentacion shtesë)-Lista e pedagogëve DSIZ dhe studentëve MSHSIE pjesmarrës në konferenca.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Msc në Sistemet e Informacionit ne Ekonomi, është program i ciklit të dytë i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma Master i shkencave.</p> <p>Programi zbaton përcaktimet e ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” me nenet përkatëse si dhe VKM nr 41. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij duke reflektuar kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga MASR.</p> <p>Mbështetur në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit, Msc në SIE është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - kredite për vitin e parë akademik 65 dhe për vitin e dytë akademik 55; - ngarkesa mësimore 3000 orë: 1230 orë në auditor; 1770 orë jashtë tij; - ngarkesa mësimore javore 20-24 orë; - forma e mësimdhënies: Leksione/seminare/ushtrime/projekte/detyra kursi. <p>Programi strukturohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 1 lëndë (7 ECTS); - kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: për profilin teknologji informacioni 10 lëndë (65 ECTS) - Kategoria C - lëndë ndërsiplinore: 3 lëndë (18 ECTS)

	<p>- Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika (12 ECTS) - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma (18 ECTS). Diploma dhe suplementi i saj, janë hartuar në përputhje me legjislacionin. Syllabuset e lëndëve janë formuluar në përputhje me udhëzimet dhe përmbajnë elementët e koncepteve bazë/rezultatet e të nxënit/temat/kodin e etikës/ orët në auditor leksion/seminar/format e kontrollit të dijes/frekuentimin/literaturën. Syllabuset janë formuluar në shqip dhe anglisht.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 52 - Ndryshimet në Planet mesimore sipas sipas VKMs - Tabela 11.</i> <i>Evidenca 15.3 - Model Suplement Diplome_MSHSIE_2022.</i> <i>Evidenca 15.1 - Modeli i Diplomës (Urdhëri i Aprovimit).</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Ekonomi synon të formojë studentë me njohuri të përgjithshme dhe specifike në fushën e sistemeve të informacionit në ekonomi. Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë profesionistë në fushën e sistemeve të informacionit, të aftë të integrojnë zgjidhjet që ofron teknologjia e informacionit me ato të proceseve të biznesit për të plotësuar nevojat për menaxhimin të informacionit apo të të dhënave për sipërmarrjet, por jo vetëm, duke u mundësuar atyre arritjen e objektivave të tyre në një mënyrë efektive dhe eficiente. Planet e studimit orientuese në fushën e sistemeve të informacionit e drejtojnë studentin në marrjen e kompetencave që mund të shfrytëzohen nga ai në zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike, analizës së sistemeve, si dhe ofrimin e kontributit të tyre në përmirësimin e administrimit të biznesit, menaxhimin financiar, turizmit dhe ekonomisë në përgjithësi.</p> <p>Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të punësohen apo të vijnë në karrierën e tyre profesionale (pasi shumica janë të punësuar kur regjistrohen) kryesisht në kompani private. Si u përmend më sipër, por edhe nga takimi me studentët e regjistruar në këtë program studimi, studentët kanë njohuri të përgjithshme nga lëndët e teknologjisë së informacionit të marra gjatë studimeve të ciklit të parë. Nëpërmjet programit të studimit Master i Shkencave</p>

17.

	<p>në Sisteme Informacioni në Ekonomi, studentët thellojnë njohuritë në drejtim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metoda Kerkimi • Programim i avancuar në web • Inxhinjeri softëaresh • Kërkime operationale • Analizë e serive kohore • Modelim në biznes • Teknologjitë mobile • E-tregëtia " E-biznesi • Menaxhim i njohurive <p>Fusha e teknologjisë së informacionit është një sfidë më vete jo vetëm për kompanitë duke pasur parasysh ndryshimet teknologjike por edhe për të reflektuar këto ndryshime në programet e studimit. Studentët e regjistruar në këtë program studimi janë një mundësi e mirë për sugjeruar përmirësime në programin e studimit sidomos për ato kompetenca që nevojiten me ndryshimet në tregun global pas pandemisë.</p> <p>Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formues të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit MSHSIE.</i> <i>Evidenca-Aneks Tabela përmbledhese, tabela nr 10- Plani mësimor i programit master</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, janë të përcaktuara qartë objektivat formuese të cilat synojnë që:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara në sistemet e menaxhimit dhe aftësi për të komunikuar dhe bashkëpunuar me persona në role të ndryshme të sistemeve të informacionit si përdorues, menaxherë, zhvillues, analistë dhe administratorë rrjeti/baze të dhënash; b. Aftësojë studentët të arrijnë të zgjidhin probleme ekonomike duke identifikuar, analizuar, zhvilluar dhe implementuar zgjidhje bazuar në sistemet e informacionit;

	<p>c. Të diplomuarit të fitojnë aftësinë për të thelluar njohuritë aktuale të metodologjive dhe teknologjive të sistemeve të reja të informacionit për të adresuar nevojat kritike të biznesit në lidhje me kërkesat, qëllimet strategjike dhe veprimet e përditshme;</p> <p>Në tërësi lëndët dhe syllabuset reflektojnë mirë këto objektiva dhe literatura në pjesën më të madhe është e pesë viteve të fundit duke mundësuar përditësimin e koncepteve në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit MSHSIE</i> <i>Evidenca-Aneks Tabela përmbledhese, tabela nr 10- Plani mësimor i programit master</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Siç u shprehëm edhe më sipër, programi i studimit i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca teorike dhe praktike. Në tërësi, në këtë program studimi studentit i mundësohet përvetësimi i njohurive të thelluara dhe aftësimi profesional me qëllim përshtatjen, sa më shumë të jetë e mundur, nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit por edhe më gjerë.</p> <p>Punimi i temës së diplomës është një tjetër element i rëndësishëm në formimin e kompetencave profesionale, sepse krahas aftësisë për të eksploruar, thelluar në literaturë, përdorimit të analizave të natyrës cilësore dhe sasiore, kërkon interpretim të rezultateve, sintezë e deduksion në formulimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve, të aftëson në të shkruarin shkencor dhe për punë të pavarur kërkimore.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit MSHSIE</i> <i>Evidenca-Aneks Tabela përmbledhese, tabela nr 10- Plani mësimor i programit master</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është pjesë e ciklit të dytë të studimeve dhe përmban elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit në përputhje me kriteret e vendosura në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.</p>

	<p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca-Aneks Tabela përmbledhese, tabela nr 10- Plani mësimor i programit master</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program organizohet në module/lëndë me kredite ECTS dhe lëndët grupohen sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 si vijon:</p> <p>A. Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme – 1 lëndë, 7 kredite ECTS (5.8 % e totalit të krediteve);</p> <p>B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik – 10 lëndë, 65 kredite ECTS (56.7 % e totalit të krediteve);</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje – 3 lëndë (2 prej te cilave me zgjedhje), 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve);</p> <p>D. Lëndë plotësuese - praktikat profesionale – 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve të këtij programi);</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës – 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve).</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca nr 2.7-Plani mësimor korrigjuar-Tabela 10 dhe Tabela 11.pdf</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit ka 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 2 vite akademike sipas detyrimeve ligjore. Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave e cila firmoset nga Dekani i FE dhe Rektori i UT.</p> <p>Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuan për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Ky i fundit paraqet një listë me tema të mundshme dhe pasi studenti zgjedh, pedagogu i dërgon strukturën e punimit. Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në rregulloren e</p>

	<p>diplomimit dhe formatin e mikrotezës së ciklit të dytë të studimeve. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template. Studentët kanë akses në këtë informacion nëpërmjet faqes së internetit të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE</i> https://feut.edu.al/images/dokumenta-studentet/te-tjera/format_mikroteze_master_shkencor.doc</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Përsa i përket këtij kriteri, GVJ vë në dukje që njësia kryesore FE dhe njësia bazë DSIZ, për programin e studimit MSc në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Organizimi i njësisë kryesore bazohet në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, statutin e UT-së dhe aktet e tjera nën-ligjore. Aktualisht njësia kryesore, FE, përgjegjëse për programin e studimit Msc në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, përbëhet nga 6 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> Departamenti i Ekonomiksit Departamenti i Financës Departamenti i Kontabilitetit Departamenti i Marketing Turizëm Departamenti i Menaxhimit Departamenti i Statistikës dhe Informatikë e Zbatuar <p>DSIZ që është përgjegjës për programin e studimit, për vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga staf akademik ndër të cilët: PAE (13) ndër të cilët 2 Prof.Dr, 4 Prof.Asoc, 5 Dr., dhe 2 MSc, ndërsa PAK (7) ndër të cilët 2 Dr., dhe 5 MSc.</p>

	<p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese- tab.1</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore për këtë program studimi, përbëhet prej 6 (gjashtë) departamentesh dhe ka të angazhuar 173 PAE dhe 326 PAK dhe 7 personel ndihmës akademik.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në program përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme me tituj akademik e grada shkencore.</p> <p>GVJ evidenton se stafi se njësia kryesore dhe ajo bazw, pwrgegjwse pwr programin e studimit, pwrmbush detyrimet ligjore pwr organizimin dhe strukturwn akademike.</p> <p>Kështu për vitin akademik 2021-2022, DSIZ, si cili mbulon me mwsimdhwnien jo vetwm lwndwt pwr kwtw program studimi por edhe lwndw nw tw gjithe FE, ka:</p> <p>32 PAE nga të cilët 5 Profesor; 7 Prof i Asociuar; 10 Dr dhe 10 janë Msc.</p> <p>81 PAK nga të cilët 2 Profesor; 1 Prof i Asociuar; 28 Dr; 1 Dr në proces dhe 49 janë Msc.</p> <p>Për vitin 2021-2022 stafi PAK mbulon vetëm 30% (405 ore) dhe stafi PAE 70% (945 orë) të ngarkesës mësimore në programin e studimit, duke qënë në përputhje të plotë me rregullin 70/30.</p> <p>Nga takimi me stafin u përmend si pikë e fortë përbërja e ndryshme moshore dhe mirëkuptimi midis tyre.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese- tab.12.1</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjeshme dhe të ftuar.</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër, bazuar në tabelat përmbledhëse të dorëzuara nga IAL:</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022 departamenti kishte angazhuar në total 32 PAE/81 PAK dhe 2 personel ndihmës akademik.</p> <p>Nga stafi PAE: 5 Prof.Dr; 7 Prof. Asoc; 11 Dr dhe 9 MSc.</p> <p>Nga stafi PAK: 2 Prof.Dr; 1 Prof. Asoc; 26 Dr dhe 51 MSc.</p>

	<p>Në vitin akademik 2020-2021 departamenti kishte angazhuar në total 31 PAE/76 PAK dhe 2 personel ndihmës akademik. Nga stafi PAE: 5 Prof.Dr; 8 Prof. Asoc; 9 Dr dhe 9 MSc. Nga stafi PAK: 2 Prof.Dr; 0 Prof. Asoc; 25 Dr dhe 47 MSc.</p> <p>Ndërkohë në vitin 2019-2020 departamenti kishte angazhuar në total 25 PAE/89 PAK dhe 2 personel ndihmës akademik. Nga stafi PAE: 5 Prof.Dr; 8 Prof. Asoc; 9 Dr dhe 4 MSc. Nga stafi PAK: 4 Prof.Dr; 2 Prof. Asoc; 28 Dr; 4 Dr në proces dhe 47 MSc.</p> <p>Numri i lartë i stafit akademik PAK lidhet edhe me ngarkesën e madhe mësimore që mbulon ky departament në të gjitha programet e studimit nga departamentet e tjera sikurse edhe në programet e studimit që ofron ky departament, konkretisht:</p> <p>1 program studimi Bsc 4 programe studimi Msc 2 programe studimi MP Gjithashtu ky departament ofron edhe 2 programe studimi të ciklit të tretë (Dr).</p> <p>Në tërësi, GVJ vëren se DSIZ ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese- tab.2; 3;</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FE si dhe njësiti bazë përbërëse të tij janë në përputhje me Statutin e UT i cili është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Si u përmend edhe më sipër FE përbëhet nga 6 njësi bazë . Në ndihmë të tyre është edhe administrata e fakultetit ashtu si parashikohet në statutin e UT-së. Njësia bazë gjithashtu përmbush detyrimin për të pasur 7 PAE minimalisht ku 3 prej tyre janë me tituj dhe grada.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 58 - Organigrama e FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Në përbërje të programit të studimit, si u përmend edhe më sipër një peshë të rëndësishme në numrin e krediteve zë praktika profesionale, me 12 ECTS.</p> <p>DSIZ ka përcaktuar një mbikqyrës pwr praktikwn profesionale brenda departamentit. Gjithashtu, studenti ka edhe një mbikqyrës praktike në institucionin ky kryen praktikën profesionale. Ashtu</p>

	<p>sikurse theksohet në rregulloren e programit të studimit, frekuentimi i praktikës duhet të jetë 100%.</p> <p>Gjithashtu, DSIZ ka në përbërjen e tij 2 personel ndihmës akademik të cilët angazhohen në mbarëvajtjen e praktikave mësimore.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE- neni 17.</i></p> <p><i>Evidenca 23 –Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë Tabela 1 4.4.2022.</i></p>						
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për programin e studimit është miratuar koordinatori i programit i cili në rastin e programit të studimit Msc në Sistemet e Informacionit në Ekonomi është drejtuesi i Këshillit të Programit të Studimit (KPS). Ky i fundit përbëhet nga 3 anëtarë të zgjedhur nga përgjegjësi i departamentit. Në rregulloren e programit të studimit, në nenin 7 dhe 8 përcaktohen detyrat e tij të cilat lidhen me organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve për mbarëvajtjen e programit të studimit. GVJ e vlerëson këtë si një praktikë pozitive për cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE- neni 7, 8.</i></p>						
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit ka detyrat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledh dhe drejton mbledhjet e KPS-së • Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me Statutin, rregulloren e UT dhe të DSIZ • Siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit, plani mësimor, syllabuset të jenë të përditësuar në cdo fillim viti akademik • Sigurohet që materialet didaktike të jenë në dispozicion të studentëve • Bashkëpunon me përgjegjësin e departamentit për kryerjen e analizës mësimore-kërkimore <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE- neni 7.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="539 1659 722 1738">Përmbushet përcërisht</th> <th data-bbox="722 1659 954 1738">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="954 1659 1177 1738">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="539 1738 722 1785"></td> <td data-bbox="722 1738 954 1785"></td> <td data-bbox="954 1738 1177 1785" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet përcërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet përcërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.3

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 35

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>FE është njësi kryesore e UT, e cila është IAL më e vjetër dhe më e madhe në vend me struktura të institucionalizuara. Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se DSIZ ka informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kreditet ECTS; b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale; ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor; e) kuotat e pranimit; ë) programin lëndor; f) profilin e programit; g) diplomën dhe suplementin <p>Për gjithë sa më sipër, GVJ vëren se kriteri 1 plotësohet.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 15.1 - Modeli i Diplomës (Urdhëri i Aprovimit)</i> <i>Evidenca 15.2 - Model Supplement Diplome_MSHSIE_2020.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</i> <i>Evidenca 52 - Ndryshimet ne Planet mesimore sipas sipas VKMs - Tabela 11.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Sikurse jemi shprehur disa herë edhe më sipër, programi i studimit i përket ciklit të dytë dhe organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione; seminare; punim esesh, detyrash apo projektesh; prezantime, provime; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; praktika profesionale.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</i></p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në leksione e seminare përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit në bazë të krediteve sipas kriterëve të specifikuar në aktet nën ligjore. Në vitin e parë studentët zhvillojnë në auditor 675 orë (65 ECTS), ndërsa në vitin e dytë, 555 orë në total (55 ECTS). Në përfundim të studimeve studenti grumbullon 120 ECTS. Viti akademik zhvillohet në dy semestra me kohëzgjatje 15 javë çdo semestër.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Si është analizuar më sipër, plani mësimor zbaton kriteret e vendosura në VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Në planin mësimor detajohen lëndët - të ndara sipas kategorive formuese si dhe në vite e semestra - dhe kreditet përkatëse. Plani detajon gjithashtu ngarkesën mësimore, orët në dhe jashtë auditorit, frekuentimin e lëndëve dhe vlerësimin e dijeve.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij - bazuar në kriteret ligjore - dhe i ka publike, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit dhe transferimit. Kuotat dhe kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, bëhen me vendim të Senatit Akademik, mbështetur në propozimet e DSIZ, miratimin e FEUT-së, në përputhje me kuotat e akorduara nga ministria e arsimit. Në nenin 10 të rregullores së programit të studimit paraqiten në formë të detajuar kushtet e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Gjithashtu edhe në rregulloren e UT, paraqiten kushtet e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i></p>

	<p><i>Kreu 3, Pranimit i studentëve, neni 11 Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit</i></p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditesuar 2016, neni 60, 102, 103.</i></p> <p><i>Evidenca 47.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021 Cikli I II-të.</i></p>		
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në IAL, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikat, dhe seminarët. Për syllabuset dhe praktikat respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018.</p> <p>Për praktikën profesionale, DSIZ nuk ka hartuar një program (syllabus) dhe udhëzime specifike për këtë program studimi. Përdoren vetëm formularët e miratuar në FE dhe që përdoren për të gjithë programet Master të ofruara nga FE.</p> <p><i>GVJ, sygjeron që departamenti të përgatisë programin e praktikës profesionale, si edhe udhëzues për praktikën. Kjo do të ndihmojë studentët për të qenë më të qartë dhe të orientuar.</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit MSHSIE</i></p> <p><i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i></p> <p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p> <p>https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet</p>		
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Institucionit i lejohej që deri në masën 20 % të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit të ndërmarrë ndryshime. IAL ka dokumentuar ndryshimet të cilat janë bërë për të qenë në përputhje me ligjin. IAL gjithashtu disponon një procedurë të institucionalizuar për përmirësimin e programit të studimit. Në të janë të përcaktuara se çfarë përfshihet në ndryshime deri në 20%. Ndër to përmendim ndryshime në shpërndarjen e krediteve sipas disiplinave përkatës, zëvendësim lëndësh, modifikim emri lënde pa ndërruar fokusin etj.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit MSHSIE</i></p> <p><i>Evidenca 52 - Ndryshimet ne Planet mesimore sipas sipas VKMs - Tabela 11.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 38

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Siç e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018. Në tërësi, GVJ vëren se organizimi dhe zhvillimi i programit dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore ETCS i mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit dhe përfitim aftësive profesionale.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se emërtimi i programit është i përshtatshëm me përmbajtjen dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktika mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe aftësimin e studentëve në studimet evropiane. Siç kemi thënë edhe më sipër lëndët e programit dhe syllabuset janë të krahasueshme me programe të ngjashme në BE dhe i ofrojnë studentëve mundësinë të fitojnë aftësi përmbajtësore dhe të vazhdojnë më tej studimet në ciklin e tretë.</p> <p><i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ vëren, siç ka vërejtur edhe më sipër, që lëndët dhe shpërndarja e tyre i mundësojnë studentëve pajisjen dhe zbatimin në praktikë të aftësive metodologjike dhe njohurive teorike të cilat përdoren në projektet, detyrat e kursit si dhe në punimin e mikrotezes. Gjithashtu përfshirja e studentëve në projekte dhe në konferenca studentore është një element më shumë i aftësimin metodologjik në praktikë. Të gjitha këto lehtësojnë dhe mundësojnë integrimin e të diplomuarve në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i></p>

	<p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p> <p><i>Evidenca 43.2.3 - Puna kerkimore shkencore 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidenca 43.3.2 - Aktivitetet shkencore DSIZ.</i></p> <p><i>Evidenca 43 - Tabela 19_20_22-Te dhena per kerkimin shkencor ne 5 vitet e fundit DSIZ.</i></p> <p><i>Evidenca nr 3.0 (dokumentacion shtesë)-Lista e pedagogëve DSIZ dhe studentëve MSHSIE pjesmarrës në konferenca.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të ngjashme ndërkombëtare. Bazuar edhe në RVB si edhe në takimin me përgjegjësin e DSIZ, ky program është i ngjashëm specifikisht me programe studimi të ofruara në Gjermani. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit i shërben IAL-së për të ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit MSHSIE</i></p> <p><i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijten e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ vuri re se në leksione përdorej gjërësisht metoda 'case study' në leksion e cila mundësonte gërshetimin e teorisë me situatë praktike sikurse edhe përdorimi i software-ve të ndryshëm. Duke patur parasysh edhe faktin që një pjesë e konsiderueshme e studentëve kur regjistrohen janë të punësuar, kjo krijon mundësi edhe për diskutime dhe detyra të nivelit më praktik si dhe për identifikim kompetencash të reja që mund t'i vijnë në ndihmë KPS për përmirësime të vazhdueshme të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Çdo lëndë ka syllabusin në gjuhën shqipe dhe angleze. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se stafi bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>

TF

[Signature]

	<p><i>Evidenca 45 - Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit.pdf</i> <i>Evidenca 45.1 - Biblioteka-Lista e dokumentave per akreditim.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në analizën e kriterëve 2,3,4,5 dhe 6 GVJ vëren se edhe kriteri 7 përmbushet pasi në tërësi është derivat i tyre. Nga analiza sidomos e syllabuseve, GVJ evidenton se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumentave të vlerësimit. Të gjitha këto mundësojnë përfitimin e dijeve të një programi të ciklit të dytë.</p> <p><i>Evidenca Aneks Tabela Permbledhese. Tabela 10. Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, diplomimi nga një program Msc i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të tretë. Ky program studimi duke ofruar edhe trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. Përsa i përket tregut të punës, studentët mund të punësohen në sektorin privat, por nuk përjashtohet edhe sektori publik.</p> <p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i> <i>Evidenca 55 - Rregullorja e doktoratures- FEUT</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>FEUT ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, të sektorit publik dhe privat. Nga bashkëpunimi me to, në mënyrë kryesisht <i>ad hoc</i>, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave të tregut të punës. Institucionalizimi i metodologjisë së tregut të punës me partnerët me të cilët IAL ka marrëveshje shërbejnë për identifikimin e kompetencave dhe nevojave të tyre. Kjo e ndihmon IAL të zhvillojë dhe praktikën e analizës së rezultateve nga marrëveshjet midis palëve.</p> <p><i>Evidenca 34.4 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023.</i> <i>Evidenca 32 34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022.</i> <i>Evidenca 29.1 - Alumni_IE-FEUT_Database.</i></p>
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, GVJ evidenton se programi i studimit duke ofruar trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë.</p>

shkencor në ciklin e tretë të studimeve	<i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i> <i>Evidenca 55 - Rregullorja e doktoratures- FEUT</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Po aq e rëndësishme, stafi akademik në këtë program studimi angazhohet në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gjithë elementëve e tjerë të programit të studimit. Pjesa kryesore e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë PAE i DSIZ.</p> <p>Referuar të dhënave, për vitin akademik 2021-2022, rezulton se ngarkesa mësimore mbulohet nga stafi akademik PAE në masën mbi 70 %, në të tre vitet që në disponojmë të dhënat. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me tituj dhe grada shkencore, dhe të gjithë janë me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe në kërkim shkencor. Por si u përmend më sipër duhen bërë më shumë përpjekje për përfshirje të stafit në platforma si Research gate, Scopus, etj.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Bazuar në të dhënat për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar në këtë program studimi varion nga 60 - 465 orë, në të gjitha programet mësimore ku stafi është i angazhuar. Numri i lëndëve që ata mbulojnë është 2, 3 ose 4 dhe janë përputhje me fushën e tyre të studimit. GVJ vëren se mbulimi i ngarkesës mësimore për këtë program studimi për vitin akademik 2021-2022 është 70% PAE dhe 30% PAK.</p>

Bazuar në të dhënat tabelore të dërguar nga IAL rezultojnë se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin si më poshtë:

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	2	-	2	-	2	-
Prof.Assoc	4	-	5	-	5	-
Dr/Doc	5	2	4	2	3	4
Msc (Dr në proces)	2	-	-	-	-	-
Msc	-	5	1	4	1	5
Në total	13	7	12	6	11	9

Në këtë program studimi angazhohen staf i kualifikuar me tituj dhe grada në përputhje me kriteret ligjore.

Aneks Tabela Permbledhese

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

GVJ vëren se kriteri 3 plotësohet, fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Siç u shprehëm më sipër, eksperiencia akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin.

Evidenca 20 - CV_PEA_PAK.

Evidenca 24 - Tabela 6 - Të dhëna për Personelin Akademik MSHSIE.

Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.

Evidenca 43.2.3 - Puna kërkimore shkencore 2020-2021

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës

Siç u përmend edhe më sipër, bazuar edhe tek RVB, GVJ vëren se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës e cila zhvillohet në institucione me të cilat FEUT ka marrëveshje bashkëpunimi.

Mënyra e ndjekjes dhe vlerësimit të praktikës mësimore paraqitet në Rregulloren e programit të studimit, neni 17, por gjithashtu edhe

<p>dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>në faqen web të Fakultetit (https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet)</p> <p>E njejta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada pedagog PAE të FEUT-DSIZ. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga Rregullorja e Fakultetit (faqja 29-32).</p> <p><i>Evidenca 34.4 - Marreveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>GVJ, bazuar edhe në vizitën në institucion, evidentoi se Institucioni ka të angazhuar staf administrativ që ofrojnë asistencën e tyre për mirëmbajtjen e laboratorëve sikurse edhe staf akademik që ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, DSIZ ka në përbërje të tij edhe 2 (dy) persona, staf ndihmës akademik.</p> <p><i>Evidenca 23 - Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë_Tabela 1_4.4.2022</i> <i>Evidenca 58 - Organigrama e FEUT.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>GVJ është shprehur edhe më sipër se përsa i përket angazhimit me tregun e punës, Së pari, një pjesë e mirë e të diplomuarive në programin e studimit janë të punësuar dhe një pjesë e mirë kur regjistrohen janë të punësuar. Kjo është një pikë shumë e fortë e programit. <i>Megjithatë, dokumenti i tregut të punës si u analizua edhe më sipër na ofron një përmbledhje të disa kërkimeve të stafit të angazhuar në programin e studimit në drejtim të zgjedhjes së universitetit por jo një identifikim i mirëfilltë i aftësive dhe kompetencave të nevojitura. Po kështu nuk gjetëm evidencë të plotë për angazhimin e partnerëve të tregut të punës në procesin</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 44

	<p><i>e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit.</i> GVJ thekson që ka komunikime midis palëve por mungon një proces i strukturuar në këtë drejtim prandaj duhet adresuar.</p> <p><i>Evidenca 17 - Studimi i tregut te punes_final.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se kriteri 2 plotësohet. Nga takimi me studentët u informuam se ato kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre për programin e studimit, literaturën në dispozicion si dhe qasjen didaktike. Studentwt nëpërmjet pyetësorit të vënë në dispozicion nga NJSBC, shprehin mendimin e tyre në lidhje me ecurinë e programit të studimit. Gjithashtu, edhe gjatë takimit që GVJ pati me studentët e kwtij programi studimi, ata u shprehën se edhe gjatë bisedave që kanë patur me stafin akademik, kanë shprehur mendimin e tyre për përmirësimin e programit të studimit, kjo edhe për faktin që ata janë të punësuar dhe të përballur me tregun e punës.</p> <p><i>Takimi me studentët</i></p> <p><i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 40 - Pyetsorët e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet në institucion me përgjegjësit e zyrës së karrierës , GVJ u informua se, FEUT përpiqet të ruajë kontaktet me studentët e diplomuar dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Po kështu, IAL ka vënë në dispozicion të GVJ Rregulloren për Zyrën e karrierës. Në nenin 6 të kësaj rregulloreje është e institucionalizuar praktika e gjurmimit të studentëve para dhe pas diplomimi. Zyra e karrierës mban një databazë të marrëveshjeve me biznesin por edhe të Alumnit. Kjo zyrë mban marrëdhënie me të diplomuarit duke i ftuar ata në takime, projekte, vizita studimore dhe leksione të hapura. Po kështu kjo zyrë ofron dhe asistencë për studentët duke i ndihmuar në gjetjen e praktikës, përpilimit të letrës së motivimit, CV etj.</p> <p><i>Takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës</i></p> <p><i>Evidenca 29.1 - Alumni_IE-FEUT_Database.</i></p> <p><i>Evidenca 12 - Projekt Rregullore e Zyrës së Karrierës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se FEUT ka shtuar përpjekjet për të përditësuar dhe përshtatur programet e studimit me kërkesat dhe nevojat e tregut dhe partnerëve të saj. Madje edhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit" , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 45

dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, programi i studimit ka patur ndryshime në lëndë dhe në kreditet përkatëse të tyre (Evidenca 52). Gjithësesi, ne nuk ishim në gjendje të identifikonim një zbatim të kësaj qasje deri në momentin e vizitës në institucion.		
	<i>Evidenca 52 - Ndryshimet ne Planet mesimore sipas sipas VKMs - Tabela 11.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ vëren se DSIZ bazon punën kërkimore në Planin e Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022) si dhe Strategjinë e Zhvillimit të UT (2018-2023). Programi ka objektiva të qarta që formësojnë dhe reflektohen ne planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Puna kërkimore në DSIZ shihet si mjet për të aplikuar njohuritë e teknologjisë së informacionit në realitetin shqiptar. Pavarësisht situatës me fillimin e pandemisë, stafi akademik ^a ka arritur të angazhohet në aktivitete shkencore dhe kërkimore (konferenca, botime, projekte, ekspertiza etj). <i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor.</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023.</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Domumentacioni shtesë - Evidenca nr 3.0-Lista e pedagogëve DSIZ dhe studentëve MSHSIE pjesmarrës në konferenca.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	GVJ vëren se drejtimet kryesore kërkimore të DSIZ dhe programit të studimit bazohen në Planin e Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022). Si është përmendur edhe më lart, FEUT ofron mbështetje stafit për prezantime në konferenca si dhe informon vazhdimisht për t'i nxitur të përfshihen në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare. Gjithashtu, FEUT ofron mbështetje financiare për konferencat e organizuara nga institucioni, si dhe stafi akademik të marrë pjesë në to pa pagesë. <i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 46

	<p><i>Dokumentacioni shtesë- Evidenca nr 4.0-Evidencë për mbështetjen financiare të DSIZ për kërkimin shkencor.</i></p> <p><i>Dokumentacioni shtesë - Evidenca nr 5.0-Mbështetje financiare për zhvillimin e konferencave të DSIZ.</i></p> <p><i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi synon të pajisë të diplomuarit me njohuri teorike e metodologjike që mundësojnë punën e pavarur kërkimore dhe integrimin në tregun e punës.</p> <p>Studentët e FEUT janë gjithashtu të përfshirë në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ në mobilitete të zhvilluara në universite në Gjermani, Çeki, Suedi, Austri, Itali, Angli, Spanjë, Poloni, Greqi, Turqi, Luksemburg etj.</p> <p><i>Megjithatë do të ishte mirë që të kishte një numër të detajuar të mobiliteteve që kanë zhvilluar konkretisht studentët që ndjekin programin e studimit në shqyrtim.</i></p> <p><i>Evidenca 43.6 - Mobilitetet e studenteve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Ky program studimi duke qenë se është i ciklit të dytë Master i Shkencave, fokusohet në përçimin e aftësive metodologjike dhe teorike për kërkim shkencor të aplikuar. Thuajse të gjitha lëndët përfshijnë kërkim të pavarur studentor të reflektuar në detyra kursi. Gjithashtu programi ka edhe punimin e diplomës që duhet përmbyllur në fund të studimeve e cila përfaqëson një kërkim të thelluar shkencor të ngjashëm me shkrimet e artikujve shkencor.</p> <p><i>Evidenca 43.3.1 - UT_List of previous projects.</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet nga ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>DSIZ/FE si pjesë e UT varet financiarisht nga UT pasi edhe të ardhurat që mund të gjenerojë vetë, bazuar në rregullat e thesarit të shtetit, administrohen në nivel qendror. Edhe UT, si institucionet e tjera publike të arsimit të lartë në Shqipëri, vuajnë nga financimi i pjesshëm i kërkimit shkencor pasi fondet janë të limituara. Megjithatë parashikimi i një granti për pjesëmarrje në konferenca si dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare të cilat janë përmendur më sipër i ka mundësuar DSIZ të ketë output kërkimor dhe pse jo gjithmonë është i garantuar publikimi në revista në databazën SCOPUS.</p> <p><i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor.</i></p>

	<i>Dokumentacioni shtesë- Evidenca nr 4.0-Evidencë për mbështetjen financiare të DSIZ për kërkimin shkencor.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.8
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Siç e kemi thënë edhe më sipër, GVJ vëren se FEUT ka pjesëmarrje në rritje të partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Po kështu DSIZ ka zgjeruar bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare duke realizuar oponenta të projekteve, realizimin e studimeve dhe publikimeve të përbashkëta në kuadër të projekteve. <i>Evidenca 34.4 - Marreveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023.</i> <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021.</i>			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga vizita në IAL u informuam për bashkëpunimin e FEUT me institucione publike dhe kompani private. Gjithashtu, nëpërmjet internshipeve, FEUT ndihmon institucionet publike dhe private me studentë ekselentë duke i mundësuar atyre që edhe të marrin eksperiencë. <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021.</i>			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ vëren se, FEUT-DSIZ ka zhvilluar aktivitete si: konferenca, leksione të hapura, seminare, forume dhe tryeza debati me të ftuar vendas apo të huaj ku kanë marrë pjesë stafi akademik dhe studentë të këtij program studimi. Po kështu shkëmbimet në kuadër të Erasmus Mobility forcojnë kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit në projekte dhe aktivitete vendore dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021.</i> <i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ.</i> <i>Evidenca 43.3.2 - Aktivitetet shkencore DSIZ.</i> <i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

RF

[Signature]

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ vëren se IAL e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standartet e vendosura nga UT dhe ato shtetërore të cilësisë duke harmonizuar leksionet në kohë reale me ato të vëna në dispozicion nga pedagogu online. Në nivel institucional IAL-ja përdor sistemin Teams (LMS - Learning Management System), i cili i bën të mundur studentit në kohë reale të ketë qasje on-line me materialet e e përgatitura nga pedagogu si p.sh. leksione, materiale shtesë audiovizive, si dhe të kryejë vlerësimet për elementë të caktuar të mësimdhënies. Gjithashtu në nivel program-studimi UT ka vënë në dispozicion edhe udhëzuesin e pedagogut për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 03.1 - Strategjia per planin institucional per mesimdhënie ne UT.</i></p> <p><i>Evidenca 39.1 - Udhëzues i UT për zhvillimin e mësimin në distancë.</i></p> <p><i>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 46.1 - Upgrade i aplikimit softëare e-Student.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>FEUT konsideron se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies mund të arrihet vetëm nëpërmjet operimit të mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik në mënyrë periodike. Vlerësimi kryhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) studentët për elementët e mësimdhënies; ii) monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive të mësimdhënies; iii) si dhe një formular i vetvlerësimit të punës mësimore dhe kërkimore.

	<p>Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>Evidenca 25.1 - Tabela 4 - Ngarkesa mësimore e personelit akademik të DSIZ_PAE.</i></p> <p><i>Evidenca 25.2 - Tabela 4 - Ngarkesa mësimore e personelit akademik të DSIZ_PAK.</i></p> <p><i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i></p> <p><i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Për të tërhequr mendimin e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve FEUT garanton përfshirjen e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në anketim për secilën lëndë të zhvilluar si dhe garantimin e ankimimit të rezultatit të provimit sipas procedurës së përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Evidenca 40 - Pyetësorët e studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditesuar 2016</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e siguruara nga këto vlerësime, NJSBC - si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, ku përfshihen dhe rezultati i punës së personelit ndihmës akademik - harton raportin vjetor me anë të të cilit informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UT rreth rezultateve të monitorimeve, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Pas përfundimit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga pyetësorët e studentëve, hartohet raporti i cili jep të dhëna për vlerësimin e studentëve për cdo pedagog të angazhuar në këtë program studimi. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë njësi u tha se po punohet për të institucionalizuar të gjitha procedurat që lidhen me garantimin e cilësisë në të gjitha komponentët e programit të studimit. Hartimi i një plani pune nga ana e NJSBC-së dëshmon vullnetin e strukturave drejtuese në IAL për të përmirësuar këto procese.</p> <p><i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise</i></p> <p><i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.</i></p>

	<i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC.</i> <i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i>		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Raportet e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik shërbejnë për të evidentuar temat për organizimin e trajnimeve specifike lidhur me nevojat e stafit të UT, por edhe përdoret si bazë për vlerësimin e performancës së stafit si kriter për zbatimin e marrëdhënieve të punësimit i.e. kohëzgjatja, apo shpërblimi. Rezultatet e marra diskutohen edhe në mbledhjet e departamentit edhe me pedagogët në mënyrë individuale në fund të vitit akademik kur kryhet vlerësimi i stafit akademik. <i>Takimi me zyrën e NJSBC,</i> <i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ.</i> <i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit të cilesise</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Procesi i mësimdhënies dhe mësim nxënies harmonizon format tradicionale si leksionet, seminarat, apo detyrat e kursit, me projekte dhe praktikat profesionale duke mbajtur parasysh ngarkesën në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor. <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur parasysh orën e mësimi, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësimnxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik. <i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në	UT mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 51

<p>përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p><i>Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.</i></p> <p><i>Evidenca 03.1 - Strategjia per planin institucional per mesimdhënie ne UT.</i></p> <p><i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ vlerëson që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin/transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program. Numri i PAE në vitin akademik 2021-2022 për këtë program studimi është 13, prej të cilëve vetëm 2 janë me titullin MSc dhe në proces doktore dhe 11 janë me gradën Dr, Prof.Asoc dhe Prof.Dr. Kualifikimet dhe eksperiencat e përfituar brenda dhe jashtë institucionit, si dhe aplikimet në projekte kombëtare, ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e metodave didaktike të përdorura.</p> <p><i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit _MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse, tabela 6.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>FEUT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetësi i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimat e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. <i>Megjithatë procesi se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit nuk është e qartë.</i> Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e NJSBC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se struktura aktuale e NJSBCS funksionon më shumë në nivel institucioni se në nivelin e njësisë bazë duke qenë se është një strukturë relativisht e re. Megjithatë si u përmend edhe më lart, hartimi i një plani nga IAL për aktivitetin</p>

17.

	<p>monitorues të komponentëve të ndryshëm të programit të studimit përbën një hap pozitiv.</p> <p><i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit të cilesise</i></p> <p><i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore për sigurimin e cilesie NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i></p>						
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nepermjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive. GVJ sugjeron që në <i>fokus të vazhdueshëm duhet të mbahet përmirësimi i kurrikulave me informacione sa më të azhornuara duke patur parasysh se në teknologjinë e informacionit, literatura dhe kërkimi janë në evolucion të vazhdueshëm duke pasur parasysh zhvillimet në Inteligjencën artificiale dhe Digital Marketing.</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse, tabela 10.</i></p> <p><i>Takim me studentët e programit të studimit</i></p>						
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Personeli akademik gjatë leksioneve dhe seminareve alternon metoda të ndryshme të mësimdhënies për t'i dhënë mundësinë studentëve që të marrin pjesë në diskutime, të bëjnë analiza dhe të prezantojnë ato në mënyrë bindëse dhe të argumentuar. Në orët mësimore ofrohen për diskutim edhe shembuj dhe situata konkrete me qëllim që studentët të kenë mundësinë të reflektojnë nëpërmjet aplikimit direkt kompetencat e zhvilluara si edhe të reflektojnë progresin e arritur në asimilimin e programit Marrëdhënia mes pedagogeve dhe studentëve zhvillohet në respekt të rregullave të komunikimit dhe etikës institucionale.</p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit,</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse, tabela 10.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 53

<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Ambientet ku kryhet procesi mësimor plotësojnë standardet për të zhvilluar një mësimdhënie cilësore. Ambientet dhe sallat mësimore kanë hapësirat e nevojshme. Për këto shërbime dhe mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit kujdeset stafi administrativ i FEUT. Programi i studimit ka salla të dedikuara në katin e 1-të të godinës A të cilat shërbejnë për kryerjen e laboratorëve apo orëve të veçanta për lëndë të veçanta të cilat duhet të përdorin kompjutera.</p> <p><i>Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.)</i></p> <p><i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2.</i></p> <p><i>Evidenca 42.1-2 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion FEUT_Struktura e teknologjisë së informacionit_Biblioteka.</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Procesi mësimor zhvillohet në ambientet e rikonstruara dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për të siguruar nje aktivitet akademik cilësor. Laboratorët janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Disa nga programet e instaluar janë apache, eclipse, Microsoft office, si dhe eviews, stata dhe spss për përpunime të ndryshme statistikore.</p> <p>Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor dhe përfitojnë nga sistem Wireless.</p> <p><i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2.</i></p> <p><i>Evidenca 42.1-2 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion FEUT_Struktura e teknologjisë së informacionit_Biblioteka.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë nëpërmjet sistemit informatik duke përdorur materialet online por edhe forumet e hapura ndërsa studentet mund ti kontrollojnë notat dhe materialin akademik online duke patur akses kudo që ndodhen.</p> <p><i>Takim me studentët e programit të studimit dhe me sekretarinë mësimore,</i></p> <p><i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2.</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>E gjithë literatura bazë dhe ajo ndihmëse është vënë në dispozicion të studentëve si në formë fizike dhe digjitale. Ndërsa materialet kryesore mësimore të programit janë në gjuhën shqipe. Po ashtu ofrohet edhe mundësia për akses nga ana e studentëve e literaturës online dhe pa pagesë (e-library) duke i ofruar studentit mundësinë e shfrytëzimit të një databazë më të plotë dhe të azhornuar, duke</p>

7

	<p>kombinuar literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar e cila përgatitet nga pedagogu i lëndës. Pasurimi vazhdueshëm i literaturës së vënë në dispozicion garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor të parashikuara për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 45 - Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit.</i> <i>Evidenca 45.1 - Biblioteka-Lista e dokumentave për akreditim.</i> <i>Evidenca 45.2 - Link-s për aksesin në bibliotekën e FEUT.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Çdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë. Po kështu, biblioteka në bashkëpunim me njësitë kryesore sipas procedurave të përcaktuara, përcakton kërkesat për blerje librash, për shtim titujsh apo edhe kopjesh.</p> <p><i>Evidenca 45 - Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit.</i> <i>Evidenca 45.1 - Biblioteka-Lista e dokumentave për akreditim.</i> <i>Evidenca 45.2 - Link-s për aksesin në bibliotekën e FEUT.</i> <i>Evidenca 42.3 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.</i> <i>Evidenca 42.4.1 - Biblioteka-University of Tirana 2020 IPA countersigned.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Infrastruktura e bibliotekës por edhe bibliotekat online si: JSTOR, COBISS+, i ofrojnë studentëve dhe pedagogëve mundësinë për të shfrytëzuar një database kërkimor më të gjerë, si edhe mundësojnë akses në literaturën më të fundit bashkëkohore në lidhje me tematikat e programit. Aksesimi mund të kryhet vetëm në ambjentet e bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca 45.2 - Link-s për aksesin në bibliotekën e FEUT.</i> <i>Evidenca 42.3 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.</i> <i>Evidenca 42.4.2 - Manual Ulibrary.</i> <i>Evidenca 42.5 - Biblioteka-FORMULAR COBISS.</i> <i>Evidenca 42.4.1 - Biblioteka-University of Tirana 2020 IPA countersigned.</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve janë edhe ambjente të tjera të FEUT. Ambjentet e laboratorëve, të pajisur me kompjutera dhe paketa softuerike të ndryshme përveç orëve të mësimit dhe zhvillimit të orëve të laboratorit, mund të përdoren nga studentët edhe për zhvillimin e detyrave të kursit por edhe për punimet e diplomave.</p>

	<i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2.</i>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Pandemia Covid 19 përveç problemeve dhe vështirësive, tregoi ndër të tjera aftësinë e stafëve akademike për t'u përshtatur me një mjedis të ri të zhvillimit të procesit të mësimdhënies. Një nga elementët kryesorë të këtij mjedisi janë dhe përdorimi i platformave online. Stafi i angazhuar në programin e studimit përdorën platforma si google classroom dhe MS Teams. Kjo nismë e marrë në periudhën e Covid, përforcoi dhe përmirësoi përdorimin e vazhdueshëm të platformave edhe sot, nëpërmjet të cilave ofrohen leksionet, materialet shtesë, vlerësimeve dhe kryesisht komunikimi ndërmjet pedagogëve. Për të rritur aksesin dhe cilësinë e këtij komunikimi janë përgatitur dhe shpërndarë edhe manuale për aksesin dhe përdorimin e platformave online.</p> <p><i>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët.</i> <i>Evidenca 46.1 - Upgrade i aplikimit softëare e-Student.</i> <i>Evidenca 3.4 Manual perdorimi Udhezues Microsoft Teams.</i> <i>Evidenca 39.1 - Udhëzues i UT për zhvillimin e mësimin në distancë.</i> <i>Evidenca 39.2 - Rregullore e posaçme e UT për zhvillimin e provimeve online 2020 – 2021.</i></p>
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	<p>Personeli akademik dhe studentët përdorin MS Teams edhe për komunikime të brendshme si vlerësimi, notat, kontakte sqaruese për detyrat, shpërndarjen e materialeve mësimore si dhe çdo komunikim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mësimore. Për këtë qëllim përdoren edhe adresat me domainin @unitr.edu.al.</p> <p><i>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët.</i> <i>Evidenca 46.1 - Upgrade i aplikimit softëare e-Student.</i> <i>Evidenca 3.4 Manual perdorimi Udhezues Microsoft Teams.</i> <i>Evidenca 39.1 - Udhëzues i UT për zhvillimin e mësimin në distancë.</i></p>
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	<p>Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave e cila firmoset nga dekani i FE dhe Rektori i UT. Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuam për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Ky i fundit paraqet një listë me tema të mundshme dhe pasi studenti zgjedh. Pedagogu i dërgon strukturën e punimit.</p>

17.

	<p>Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në rregulloren e diplomimit dhe formatin e mikrotezës së ciklit të dytë të studimeve. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template. Studentët kanë akses në këtë informacion nëpërmjet faqes së internetit të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i> <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i> https://feut.edu.al/images/dokumenta-studentet/te-tjera/format_mikroteze_master_shkencor.doc</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat e ngritura në nivel institucional merren me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë dhe drejtohen nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSC), i cili bashkërendon punën me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e kurrikulave dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Këto zyra janë përgjegjëse për hartimin e planeve dhe aktiviteteve të monitorimit, në lidhje me syllabuset e lëndëve, dokumentacionit për programet e studimit etj. Vihet re dhe nga lista e evidencave që IAL ka vënë në dispozicion se ka një qasje proaktive në këtë drejtim. Plani i veprimit për sigurimin e cilësisë e tregon më së miri këtë tendencë. Stafi i angazhuar në NJSBC në nivel fakulteti pohoi që është një strukturë në zhvillim e sipër dhe se po bëhen të gjitha përpjekjet për ta ngritur atë sipas të gjitha standarteve të kërkuara për përmirësimin e cilësisë duke përdorur edhe eksperiencën nga IAL të tjera. <i>GVJ rekomandon shtrirjen e proaktivitetit edhe në njësinë bazë që është përgjegjëse për programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidenca. Takim me stafin e angazhuar të NjsBC</i> <i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë NJSBC.</i></p>

	<p><i>Evidenca 08.1 - Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24) re.</i></p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit të cilësisë-.</i></p> <p><i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i></p> <p><i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>DSIZ është njësia përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi”. Për këtë qëllim grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel fakulteti harton një raport vjetor ku paraqiten analizat mbi cilësinë e programit dhe hapat që duhet të ndiqen për përmirësimin e tyre. Departamenti përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, garanton që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Syllabuset e hartuara miratohen nga përgjegjësi i departamentit, i cili bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimin nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar. Stafit akademik dhe studentët janë në djeni të procedurave të vlerësimit të mësimdhënies, duke rritur vetëdijen e tyre për cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca Takim me drejtuesit DSIZ</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca nr 6(dokumentacioni shtesë)-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve - MSHSIE</i></p> <p><i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit të cilësisë-.</i></p> <p><i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i></p> <p><i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>DSIZ dhe strukturat ndihmëse në nivel UT mbështesin zbatimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies si pjesë e rëndësishme e strategjisë së institucionit. Periudha e Covid-19, mundësoi implementimin e zhvillimit online duke përdorur platforma të tilla si Teams, të cilat u përdoren edhe pas periudhës së pandemisë e në vazhdimësi jo vetëm si një mjet komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve por edhe për vendosjen e materiale mësimore apo ato ndihmëse.</p> <p><i>Evidenca Takim me drejtuesit DSIZ</i></p> <p><i>03.1 - Strategjia për planin institucional për mesimdhënie në UT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Stafit akademik i angazhuar në përgatitjen e programit të studimit kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik në zbatim edhe të direktivave dhe rekomandimeve të paraqitura në Planin Shkencor të UT 2018-2022.</p>

	<p>Në këtë aspekt, stafi akademik i programit të studimit ka kryer më shumë aktivitete duke përfutuar edhe nga projekte në të cilat është pjesë. Stafi i departamentit dhe stafi që është i angazhuar në këtë program studimi janë të angazhuar vazhdimisht në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu stafi akademik është pjesë aktive e konferencave ndërkombëtare si edhe revistave ndërkombëtare duke prezantuar dhe botuar punimet e tyre. Pjesmarrja në aktivitete të tilla ndërkombëtare, ndër të tjera shërben edhe si një mënyrë trajnimi dhe kualifikimi në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p><i>Evidenca: Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënive me Jashtë</i></p> <p><i>Evidenca: Takim me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kërkimit Shkencor.</i></p> <p><i>Evidenca 20 - CV_PEA_PAK.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimi i personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja zhvillohet në nivel institucioni, ndërsa në nivelin e DSIZ kryhet kryesisht nëpërmjet trainimeve tematike, periudhave të shkurtra të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rumbullakta, seminare me pjesmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit</i></p> <p><i>Evidenca 53 - Mbi njoftimin për ofrimin e trajnimeve Shkolla Shqiptare e administrates Publike.</i></p> <p><i>Evidenca 43.3.4 Shk_Percjellese_Ermal_Haxhiaj_kthim_pergjigje_per_workshope.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik që është përgjegjës për zbatimin dhe cilësinë e mësimdhënies merr një ndihmë të vazhdueshme nga personeli ndihmës akademik për sigurimin e një procesi cilësor të mësimdhënies por edhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe përmirësimin e syllabuseve, literaturës, si edhe të gjithë elementëve të tjerë të parashikuar në procesin e mësimdhënies. Tregues të rëndësishëm në këtë kuadër janë shkëmbimet e stafit me bursat e mobilitetit Erasmus+ për mësimdhënie dhe trajnime, duke sjellë kështu eksperiencat më të mira nga universitetet perëndimore. Gjithashtu një tregues tjetër i rëndësishëm është përditësimi i vazhdueshëm çdo vit akademik i literaturës së përdorur në lëndët e programit (Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit).</p>

	<p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i> <i>Evidenca 52 - Ndryshimet ne Planet mesimore sipas sipas VKMs - Tabela 11.</i> <i>Evidenca 3.1 - Strategjia per planin institucional per mesimdhënie ne UT</i> <i>Evidenca 45 - Lista e Librave të blera gjatë 5 viteve të fundit</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mesimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Stafi akademik kërkon vazhdimisht aplikimin e metodave bashkëkohore në mesimdhënie duke zbatuar modele specifike si për shembull metoda më interaktive në tema të caktuara por edhe duke përdorur teknologjitë e informacionit. Raportimi i rezultateve të aplikimit të metodave të reja në mesimdhënie kryhen nga vetë pedagogët dhe përfshihet në vetvlerësimin e përgjithshëm të performancës së punës së tyre mesimore dhe kërkimore. Megjithatë një procedurë specifike dhe periodike të një analize mbi efektet dhe pritshmëritë nuk u vu re.</p> <p><i>Evidenca nr 6(dokumentacioni shtesë)-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve - MSHSIE</i> <i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise-.</i> <i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i> <i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT.</i> <i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mesimdhënie dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Në funksion të përmirësimit të procesit të mesimdhënie, DSIZ ka përfshirë në procesin e mesimdhënie lektorë të ndryshëm vendas apo të huaj, falë bashkëpunimeve në kuadër të programeve të bashkëpunimit. Sikurse u përmend edhe me lart DSIZ është përfshirë në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rrumbullakta, seminare me pjesëmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit</i> <i>Evidenca 53 - Mbi njoftimin per ofrimin e trajnimeve Shkolla Shqiptare e administrates Publike.</i> <i>Evidenca</i> <i>43.3.4Shk_Percjellese_Ermal_Haxhij_kthim_pergjigje_per ëorkshope.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

FF

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kontrolli i dijeve dhe përvetësimit të objektivave të programit dhe kompetencave profesionale të parashikuara bëhet nëpërmjet harmonizimit të disa komponentëve si për shembull testimet e vazhdueshme me shkrim dhe me gojë, prezantimet e projekteve dhe detyrave të kursit, praktikave të përfshira në programin e kursit, frekuentimit dhe diskutimeve në auditor, por edhe provimeve me shkrim ose me gojë, etj.</p> <p>Të gjitha këto forma përcaktohen në rregulloren e programit të studimeve ku përfshihen edhe mënyra e kontrollit të dijeve në lëndët përkatëse. Studentët njoftohen mbi këtë rregullore gjatë javës së (parë të fillimit të studimeve) orientimit, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Rregullorja dhe afatet e përcaktuara në kalendarin akademik bëhen publike dhe mund të konsultohen online.</p> <p>Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës i programit të studimit studentët udhëzohen për formën dhe përmbajtjen e punimit të diplomës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i> <i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i> <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës në çdo semester, pedagogu i lëndës i njeh studentët me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/ semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Në DSIZ bëhet një vlerësim i vazhdueshëm i njohurive në të gjitha lëndët, duke analizuar performancën e studentit në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe në funksion të arritjes së objektivave të programit si dhe bazuar në rregulloren e FE (<i>Evidenca 06.2 -Faculty of Economics, Regulation, Kontrolli i dijeve</i>). Nga vlerësimi i syllabuseve vihet re se kontrolli i vazhdueshëm i dijeve bëhet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 61

FF.

[Signature]

	<p>nëpërmjet: projekteve, provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit etj. Në syllabus janë të paraqitura edhe pesha e secilit element vlerësimi në vlerësimin final.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje (0-100%) e notës përfundimtare. Niveli i të nxënit vlerësohet përmes detyrave me shkrim dhe /ose me gojë duke përfshirë angazhimin në diskutime, për ese të përgatitura gjatë seancave mësimore. Kështu në këtë program studimi,</p> <ul style="list-style-type: none"> • aktivizimi gjatë seminareve vlerësohet deri në 10% të vlerësimit total, • detyrat e kursit, laboratorët deri në 30% të vlerësimit, • provimi i ndërmjetëm ose testime gjatë vitit deri në 30% të vlerësimit • provimi përfundimtar 30-70% të vlerësimit. <p>GVJ mendon që shpërndarja e ngarkesës dhe vlerësimit gjatë gjithë vitit e mban studentin të angazhuar në mënyrë më efektive. Provimi final realizohet me shkrim sipas rregulloreve, UT, e programit te studimit etj.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Gjatë periudhës së Covid-19, sikurse edhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend, edhe në FE, mësimi, por edhe provimet, u zhvilluan online. Për këtë Institucioni hartoi rregulla dhe procedura si për zhvillimin e mësimit online, ashtu edhe për zhvillimin e provimeve online.</p> <p>Aktualisht në FE përdoret sistemi elektronik për kontrollin e provimeve. Praktika e përdorimit të Clean Score eliminon abuzimet</p>

	<p>dhe rrit transparencen. Gjithashtu, pedagogët nëpërmjet platformës Teams, komunikojnë me studentët rezultatet dhe vlerësimin e testimeve.</p> <p><i>Evidenca 39.2 - Rregullore e posaçme e UT për zhvillimin e provimeve online 2020 – 2021.</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca 42.4 - Biblioteka-Manual_JSTOR_1.cdr - raë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për vlerësimin e provimeve nuk angazhohen anëtarë të tjerë përveç titullarit të lëndës, me përjashtim të rastit kur lënda ka edhe një asistent, pra vetëm në rastin kur lënda zhvillohet nga më shumë se një pedagog, atëherë pedagogët që e kanë zhvilluar lëndën përfshihen edhe në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Tezat e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës, nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit, duke patur si qëllim që të vlerësojnë njohuritë e studentëve. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës dhe ndjek zhvillimin e provimit.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca 05 - Projekt Rregullorja UT FINAL.</i></p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE_UT_perditesuar_2016.</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. FEUT ka sistem të dedikuar Clean Score për të kryer sekretimin dhe ruajtjen e anonimatit të studentit. Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidenca 05 - Projekt Rregullorja UT FINAL.</i></p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE_UT_perditesuar_2016.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregulloret e UT parashikojnë vlerësim të detajuar për çdo pyetje dhe sqarime dhe argumentime për vlerësimin e marrë nga studenti për çdo detyrim të lëndës. Pedagogu në detyra kursi dhe provime të ndërmjetme bën edhe komente apo korrigjime në lidhje me pasaktësitë në përgjigjet e dhëna.</p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE_UT_perditesuar_2016 neni 48, neni 51</i></p>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rregulloren e UT janë të paraqitura rregullat e zhvillimit të provimit, studenti paraqitet në provim me mjet identifikimi dhe ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm me përjashtim të përgjegjësit të departamentit dhe personave të tjerë të autorizuar nga Dekani ose Rektori. Gjithashtu ashtu sikurse cilësohet në rregulloren e institucionit sikurse edhe në Kodin e Etitës UT, ndalohet dhe nuk tolerohet kopjimi, plagjatura apo sjellje të tjera jo etike.</p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE__UT_perditesuar_2016 neni 48, neni 50, 51</i> <i>Evidenca 02.1 - Draft-kodi i etikes UT.</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UT, rregulloren e FE si edhe të programit të studimit. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të tezës. Rezultatet e vlerësimeve të provimeve bëhen në përfundim të provimit për provimet me gojë brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të tyre për ato me shkrim. Pas korrigjimit provimet dorëzohen brenda 5 ditëve në sekretarinë mësimore së bashku me procesverbalet përkatëse. Notat i jepen studentit nga sekretaria mësimore ose nëpërmjet aksesit online. Vlerësimi për komponentët e tjerë i dorëzohet studentit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve .</p> <p><i>Evidenca 05 - Projekt Rregullorja UT FINAL.</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE__UT_perditesuar_2016.</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit _MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtë që të ankohet për rregullat e zhvillimit të provimit brenda 24-orëve nga data e provimit dhe ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit, i cili nëse verifikon shkelje të korrigjueshme ndërmerr hapat e nevojshëm së bashku me komisionin e provimit. Në rast se shkeljet nuk janë të korrigjueshme atëherë vendimi i përcillet Dekanit që nëse e shikon me vend merr vendim për anulimin e provimit dhe ri-zhvillimin e tij.</p> <p><i>Evidenca 05 - Projekt Rregullorja UT FINAL.</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE__UT_perditesuar_2016.</i> <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation</i></p>

	<i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i>		
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ankohet brenda 48 orësh me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e problemit e përcjell tek Dekani. Dekani ngre brenda 48 oreve nga marrja në dijeni për ankesën ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE_UT_perditesuar_2016. (neni 50-51)</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në Sistemet e Informacionit në Ekonomi, synon që të pajisë studentin me njohuritë e nevojshme si në profilin akademik ashtu edhe profesional. Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë profesionistë në fushën e sistemeve të informacionit, të aftë të integrojnë zgjidhjet që ofron teknologjia e informacionit me ato të proceseve të biznesit për të plotësuar nevojat për menaxhimin e informacionit apo të të dhënave për sipërmarrjet, por jo vetem, duke u mundësuar atyre arritjen e objektivave të tyre në një mënyrë efektive dhe eficiente. Po kështu vlen për tu përmendur ndërgjegjësimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi për të orientuar kërkimin e tyre shkencor në funksion të syllabuseve në të cilët ata janë titullarë për një periudhë të gjatë kohore. <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ.</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i> <i>Evidenca 20 - CV_PEA_PAK.</i>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Ekonomi synon të formojë studentë me njohuri të përgjithshme dhe specifike në fushën e sistemeve të informacionit në ekonomi.</p> <p>Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë profesionistë në fushën e sistemeve të informacionit, të aftë të integrojnë zgjidhjet që ofron teknologjia e infomacionit me ato të proceseve të biznesit për të plotësuar nevojat për menaxhimin të informacionit apo të të dhënave për sipërmarrjet, por jo vetem, duke u mundësuar atyre arritjen e objektivave të tyre në një mënyrë efektive dhe eficiente.</p> <p>Planet e studimit orientuese në fushën e sistemeve të informacionit e drejtojnë studentin në marrjen e kompetencave që mund të shfrytëzohen nga ai në zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike, analizës së sistemeve, si dhe ofrimin e kontributit të tyre në përmirësimin e administrimit të biznesit, menaxhimin financiar, turizmit dhe ekonomisë në përgjithësi.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentin, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Si rregull, në përfundimit të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu detyra e kursit dhe punët e laboratorit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda.</p> <p><i>Evidenca 19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të lëndës pedagogu rikthen në fokus për studentët çështjet apo konceptet më të rëndësishme të trajtuara si dhe jep orientimet e nevojshme për përgatitjen për provim. Kjo është një praktikë që zbatohet nga programi në javën e 15 të semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik te angazhuar ne programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor me lektorë apo ekspertë të ftuar me qëllim që të informojë kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Sikurse u përmend dhe më sipër institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por gjithashtu konfirmuar edhe nga intervista me stafin organizohen edhe trajnime specifike (<i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit</i>). Kualifikimi i vazhdueshëm në fushën</p>

FF.

	<p>profesionale dhe atë të mësimdhënies, sikurse edhe kërkimi shkencor janë pjesë e Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Ekonomisë si edhe të DSIZ.</p> <p><i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ.</i></p> <p><i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023.</i></p> <p><i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor.</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi harmonizon njohuritë teorike me aspektin praktike, përmes projekteve tematike, detyrave të kursit dhe orëve të laboratorit ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra.</p> <p>Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila nën mbikqyret nga një pedagog i departamentit ndihmon në rritjen e aftësive profesionale dhe mundësi më të mira për integrimin në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Përmes detyrave të kursit, simulimit të situatave reale apo edhe diskutimet me ekspertë të jashtëm, stafi akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Për të nxitur një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, stafi akademik përpigjet të organizojë dhe mbështesë studentët në zbatimin e aktivitete specifike duke përdorur laboratorët dhe paketat softuerike të instaluar në kompjuterat e laboratorëve edhe duke nxitur studentet te marrin pjesë në konferenca shkencore. Gjithashtu sistemi i Alumni bën të mundur që ish studentë të programit të studimit të ftohen për të ndarë eksperiencat e tyre nga sektori. Qendra e karrierës fton gjithashtu përfaqësues të bizneseve që në bashkëpunim me personelin akademik zhvillojnë takime rreth ideve te biznesit.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p> <p><i>Evidenca (dokumentacioni shtesë) nr 3.0-Lista e pedagogëve DSIZ dhe studentëve MSHSIE pjesmarrës në konferenca.</i></p> <p><i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor</i></p> <p><i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ.</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Programi synon vendosjen e kërkimit shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafik akademik, por edhe transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, nëpërmjet përfshirjes së tyre në projekte. Referuar dokumentacionit,,</p>

	<p>në tre vitet e fundit, 6 studentë janë aktivizuar në punimet shkencore të pedagogëve, ndërsa 10 studentë janë aktivizuar në projekte shkencore në rang Departamenti, ndërsa 30 studentë kanë marrë pjesë në aktivitetet e projektit të financuar nga AKKSHI "Ndërveprimi Universitet – Sipërmarrje si një instrument strategjik për transferimin reciprok të dijeve". Gjatë takimit në institucion me pedagogët, GVJ u informua se në mjaft raste, studentët për realizimin e temës së diplomës janë pjesë e projekteve të pedagogëve.</p> <p>Në evidencën 43.6 paraqitet lista e mobiliteteve të FEUT, mirë do të ishte që të kishte një detajim edhe të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Sistemet e Informacionit në Ekonomi.</p> <p><i>Evidenca (dokumentacioni shtesë) nr 3.0-Lista e pedagogëve DSIZ dhe studentëve MSHSIE pjesmarrës në konferenca.</i></p> <p><i>Evidenca 03.2 - UT Plani i Kerkimit Shkencor</i></p> <p><i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ.</i></p> <p><i>Evidenca 43.6 - Mobilitetet e studenteve.</i></p> <p><i>Evidenca 43.3.3 - Permbledhje e projekteve FEUT Janar 2021.</i></p> <p><i>Evidenca 43.3.2 - Aktivitetet shkencore DSIZ.</i></p>						
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Ndërkombëtarizimi është pjesë integrale e UT por edhe DSIZ. Programet e mobiliteteve zhvillohen me pjesmarrjen e studentëve dhe pedagogëve si per shembull +KA107 apo programe mobiliteti për studentët.</p> <p><i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit.</i></p> <p><i>Evidenca 43.6 - Mobilitetet e studenteve</i></p> <p><i>Evidenca 43.4 Incoming students.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="523 1317 734 1391">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="734 1317 963 1391">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="963 1317 1181 1391">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="523 1391 734 1438"></td> <td data-bbox="734 1391 963 1438"></td> <td data-bbox="963 1391 1181 1438" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit përfundon me Mbrojtjen e Temës së Diplomës përpara një komisioni, i cili përbëhet nga të paktën dy pedagogë dhe ngrihet për këtë qëllim. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë</p>

	<p>që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij.</p> <p><i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE (neni 6).</i></p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Studenti udhëhiqet gjatë periudhës së përgatitjes së tezës nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit. Për përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nga pedagogu udhëheqës, i cili ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera me pedagogun udhëheqës dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera të tilla si Teams, që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës.</p> <p>Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në rregulloren e diplomimit dhe formatin e mikrotezës së ciklit të dytë të studimeve. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template. Studentët kanë akses në këtë informacion nëpërmjet faqes së internetit të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i></p> <p>https://feut.edu.al/images/dokumenta-studentet/te-tjera/format_mikroteze_master_shkencor.doc</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i studimit përfundon me Mbrojtjen e Temës së Diplomës dhe jo me provim final.</p> <p><i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i></p> <p>https://feut.edu.al/images/dokumenta-studentet/te-tjera/format_mikroteze_master_shkencor.doc</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët</p>	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i DSIZ i profilizuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja e temave bëhet</p>

<p>në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>nga studentët në bazë të temave që paraqesin ata ose pedagogët e programit. Udhëheqja e studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratur nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe pedagogun udhëheqës bëhet pranë kordinatorit të programit i cili harmonizon kërkesat e studentëve me mundësitë reale pa cënuar cilësinë e punimeve të diplomave dhe duke evituar përsëritjet.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Takimi me stafin dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në përgatitjen e temës së diplomës studentët ndihmohen nga stafi i programit për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, hedhjen e të dhënave grafike apo statistikore, përpunimin e pyetësorëve apo anketave duke përdorur të gjithë infrastrukturën e bibliotekave, sallave të kompjuterave por edhe duke shfrytëzuar bazën kërkimore apo arshivën e institucioneve të tjera me të cilat programi ka marrëveshje bashkëpunimi. Për analizën dhe përpunimin e të dhënave, studentët ndër të tjera mund të përdorin edhe sallat laboratorike të cilat janë të pajisura me softëare si Eviews, Stata, Spss.</p> <p><i>Takimi me stafin dhe studentet</i> <i>Vizita ne IAL, sallat e kompjuterave dhe laboratorëve</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temave të diplomës e udhëheq studentin gjatë gjithë periudhës së përgatitjes së saj duke e orientuar studentin për përgatitjen e temës në zbatim të udhëzuesve të miratuar dhe në përmbushje të standarteve akademike. Punimi i diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit dhe rregullat e etikës akademike. Në përfundim, udhëheqësi i temës nënshkruan temën e diplomës që do të mbrohet përpara komisionit të krijuar nga DSIZ.</p> <p><i>Takimi me stafin dhe studentet</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni i ngritur për këtë qëllim. Sezonet e rregullta të mbrojtjes së diplomës janë ato të verës, vjeshtës dhe dimrit ndërsa sezone specifike mund të përcaktohen me urdhër të të Dekanit. Anëtarët e komisionit bien dakord për notën dhe në rast se kjo nuk arrihet vendoset mesatarja e notave të propozuara nga të dy anëtarët.</p> <p><i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i></p>

	<i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i> <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i>			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” dhe suplementin e saj, sipas formatit të miratur nga MASR dhe i firmosur nga Dekani i FE dhe Rektori i UT. <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 15.3 - Model Suplement Diplome_MSHSIE_2022</i> <i>Evidenca 10 - Projekt Rregullore e Diplomimit në UT dhe Rregullore e NJSBC.</i> <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE.</i>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të programit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE.</i> <i>Evidenca 15.3 - Model Suplement Diplome_MSHSIE_2022</i>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje me detyrimet institucionale, informacioni i paraqitet palëve të interesuara në përputhje me normativat ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vetë institucionit. <i>Takim me Degën e Burimeve Njerëzore</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në UT ka në strukturën e tij edhe Degën e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës e cila duke ju referuar edhe në organigramës së FEUT është në varësi të drejtpërdrejtë nga Dekani i FEUT-së dhe funksionon në koordinim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të UT. Kjo degë është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ të punësuar në FEUT.</p> <p>Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ konstatoi se për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet dokumentacioni i nevojshëm, por jo i gjithë dokumentacioni është i përfshirë në një dosje të vetme. GVJ u informua se të dhënat përditësohen periodikisht në fillim të vitit akademik ose atëherë kur kjo është e nevojshme si p.sh. shtimi i ndonjë gradë shkencore ose titulli akademik, etj dhe se po punohet për grumbullimin e informacionit në një dosje të vetme. Përsa i përket angazhimit të personelit në çdo semestër dhe vit akademik, ky informacion mbahet nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.</p> <p><i>Evidenca 58-Organigrama e FEUT;</i> <i>Evidenca 05.1-RREGULLORE _UT_perditesuar_2016, neni 13</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik me kohë të plotë, me kontratë të përkohshme dhe të ftuar në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar bëhet në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet e tjera ligjore dhe nëngjore, të shprehur në Statutin e UT, nenet 67 dhe 68 dhe në Rregulloren e UT, nenet 25 dhe 26. Në manualin e cilësisë së UT specifikohet se kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi drejtohet nga</p>

	<p>një komision <i>ad hoc</i>, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditesuar 2016, neni 25, 26;</i> <i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në rregulloren e UT (neni 23) përcaktohet se Përgjegjësi i Departamentit i rekomandon dekanatit kriteret e posaçme të pranimit të personelit akademik e ndihmës mësimor shkencor për departamentin, pas diskutimit paraprak në departament. Referuar faqes web të FEUT, në të gjenden publikime të shpalljes së vendeve të lira të punës. Publikimi i vendeve të lira të punës bëhet edhe në rubrikën përkatëse të faqes web të UT. GVJ u njoh edhe me procedurën e rekrutimit të stafit akademik gjatë vizitës së kryer pranë Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës të FEUT dhe është i mendimit se procedura e parapërcaktuar zbatohet në mënyrë korrekte. Gjithashtu, në takimet e zhvilluara me përgjegjësen e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, GVJ konstaton përpjekje të përthithjes së kandidaturave më të mira në drejtim të punësimit të stafit akademik me kohë të plotë.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditesuar 2016</i> https://feut.edu.al/lajmerime/1915-njoftim-vende-te-lira-pune-prane-fakultetit-te-ekonomise-per-personel-ndihmes-akademik-me-karakter-administrativ-shpallur-ne-buletinin-nr-160-date-21-nentor-2022 https://unitir.edu.al/category/njoftim-per-vend-te-lire-pune/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Neni 67 i Statutit të UT përcakton procedurën e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë duke e përcaktuar realizimin nëpërmjet një konkurimi të hapur përmes një procesi transparent, të paanshëm dhe objektiv. Gjithashtu në Statut përcaktohet se Dekani krijon komisionin <i>ad hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni <i>ad hoc</i> përbëhet nga pesë anëtarë, që nuk duhet të kenë konflikt interesi dhe që i përkasin kategorisë Profesor.</p> <p>a) dy anëtarë përzgjidhen nga Përgjegjësi i departamentit, për të cilin është shpallur procedura e konkurrimit.</p> <p>b) dy anëtarë përzgjidhen nga drejtuesi i njësisë kryesore, ku së paku njëri prej tyre duhet të jetë anëtar i departamentit, i cili ka shpallur procedurën e konkurrimit;</p>

	<p>c) një anëtar caktohet nga Rektori i Universitetit, me kërkesë të drejtuesit të njësisë kryesore.</p> <p>Vlerësimi kalon në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista. GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se për vlerësimin e kandidatëve përdoret një sistem pikëzimi (i cili përcaktohet për çdo konkurim nga ana e komisionit <i>ad hoc</i>) ku pesha e dosjes varion nga 60 në 70%, ndërsa vlerësimi i intervistës nga 30 në 40%. Komisioni <i>ad hoc</i> i paraqet kandidatin/kandidatët fitues Rektorit të UT-së përmes drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori, brenda 10 ditëve nga shpallja e kandidatit/kandidatëve fitues, nënshkruan kontratën e punës me të/ta dhe nga ky moment fillojnë marrëdhëniet e punës. GVJ është i mendimit se një sistem pikëzimi i përcaktuar paraprakisht dhe i standartizuar do të kontribonte në një përzgjedhje më objektive të kandidatëve fitues.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE_UT_perditesuar_2016</i> <i>Takime në institucion</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se FEUT ka synuar në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Në planin strategjik të DSIZ përcaktohet si një nga prioritetet e tij në drejtim të personelit dhe infrastrukturës sigurimi i mundësive që ndihmojnë zhvillimin profesional të stafit nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes në konferenca profesionale, seminare dhe workshop-e. Në drejtim të infrastrukturës, GVJ u informua se rikonstruksioni i godinave i realizuar së fundmi u ka ardhur në ndihmë si stafit akademik dhe administrativ, ashtu edhe studentëve për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit mësimor. Gjithashtu, konstatohet se institucioni ka siguruar investime, të cilat ofrojnë mjedise të mirëpajisura për çdo anëtar të stafit akademik dhe</p>

	<p>administrativ, që u krijon mundësi të barabarta për realizimin e detyrave të tyre profesionale</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset në të cilat zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit janë të përshtatshme për zhvillimin cilësor të programit. Auditorët, zyrat, laboratorët janë të pajisura me të gjithë mjetet didaktike që mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ;</i> <i>Evidenca 42.1-2 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion FEUT_Struktura e teknologjisë së informacionit_Biblioteka;</i> <i>Evidenca 03.0 - Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023;</i> <i>Evidenca 03.1 - Strategjia per planin institucional per mesimdhënie ne UT;</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personeli akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përse i përket kualifikimit. Nga të dhënat e disponueshme për vitin akademik 2021-2022, rreth 67% e personelit akademik efektiv të DSIZ është me tituj e grada e me përvojë të madhe në fushat respektive të ekspertizës. FEUT dhe DSIZ zhvillojnë përpjekje të vazhdueshme në drejtim të mbështetjes së stafit akademik. Plani strategjik i DSIZ paraqet rezultatet e pritshme për vitet e ardhshme ku synohet rritje e stafit të angazhuar në departament me kualifikimet përkatëse sipas kategorive - rritje e numrit në kategorinë profesor, rritje e numrit në kategorinë doktor dhe angazhimi i stafëve të reja, kandidatë doktorantë si dhe një numër në rritje i stafit të trajnuar në workshop-e, seminare në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për një pjesëmarrje të gjerë në thirrjet për projekte si Erasmus+, Horizon 2020, Jean Monet, projekte të financuara nga AKKSHI, AUF, etj.</p> <p>Kualifikimit të vazhduar shkencor i shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL jashtë vendit konkretizuar nëpërmjet mobiliteteve të stafit akademik të DSIZ. Mbështetja në drejtim të kualifikimit konkretizohet edhe nëpërmjet mbështetjes financiare të institucionit për mundësimin e publikimeve, të pjesëmarrjes në konferencat e organizuara prej institucionit ashtu sikurse dhe në sponsorizimin për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. Kjo mundësohet nëpërmjet një buxheti modest për departamentin në mbështetje të kërkimit shkencor (rreth 1 milion lekë në vit).</p>

	<p><i>Evidenca 23.2 - Tabela 2 - Të dhëna për stafin akademik të DSIZ</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ;</i> <i>Evidenca 43.3.3 - Permbledhje e projekteve FEUT Janar 2021</i> <i>Evidenca 43 - Tabela 19_20_22-Te dhena per kerkimin shkencor ne 5 vitet e fundit DSIZ</i> <i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit</i> <i>Takim me Dekanin e FEUT</i></p>																				
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se DSIZ i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka mbështetur kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik si dhe eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik si dhe trajnimet e realizuara nga institucioni. Me impakt të konsiderueshëm në këtë drejtim ka qenë dhe një trajnim intensiv në fushën e pedagogjisë dhe mësimdhënies i 48 pedagogëve efektivë që kanë nisur punën rishtazi si personel akademik kohë të plotë pranë FEUT.</p> <p>GVJ u informua se në UT është ngritur që prej vitit 2021 "Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe trajnimit". Kjo qendër organizon në mënyrë periodike trajnime apo seminare të ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave dhe përfundimit të elementëve me interes si në drejtim të kualifikimit individual ashtu edhe në drejtim të marrjes së informacioneve për çështje të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit.pdf</i> https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/ <i>Takim me Dekanin e FEUT</i></p>																				
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>GVJ konstaton se për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave "Sisteme Informacioni në Ekonomi" FEUT ka angazhuar dhe angazhon staf akademik me grada dhe tituj dhe me eksperiencë të gjerë në fushat respektive të ekspertizës. Kontribut të qënësishëm për mbarëvajtjen dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit jep dhe stafi ndihmës akademik dhe ai administrativ. Për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 ngarkesa mësimore për programin e studimit është mbuluar nga personeli akademik si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="526 1720 1380 1901"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti</th> <th colspan="3">PAE (kategoria)</th> <th colspan="3">PAK (kategoria)</th> </tr> <tr> <th>Profesor (Prof/Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> <th>Asist. (MSc.)</th> <th>Profesor (Prof/Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> <th>Asist. (MSc.)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Viti	PAE (kategoria)			PAK (kategoria)			Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Asist. (MSc.)	Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Asist. (MSc.)							
Viti	PAE (kategoria)			PAK (kategoria)																	
	Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Asist. (MSc.)	Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Asist. (MSc.)															

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 76

	2019-2020	7	3	1	-	4	5
	2020-2021	7	4	1	-	2	4
	2021-2022	6	5	2	-	2	5

duke dëshmuar për një angazhim optimal të burimeve njerëzore për të përmbushur objektivat e programit të studimit.
Evidenca RVB_Shqip, Aneks Tabela 7
Evidenca 20 - CV_PEA_PAK
Evidenca 22 - CV_PNA

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se FEUT disponon mjediset të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në auditor. Megjithatë, referuar të dhënave për infrastrukturën në funksion FEUT rezulton se, megjithëse mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të përshtatshme, ato nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme duke qenë se në mundësohet rreth 1.6 m ² /student (duke qenë larg normativës së sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8–4.0 m ² /student). Në total për FEUT sallat e leksionesh janë 27, me një sipërfaqe totale e tyre është 2752.4m ² ndërsa salla seminaresh janë gjithsej 22 me sipërfaqe totale 1028.4 m ² . Në ambient disponohet edhe një sallë për aktivitete promovuese me sipërfaqe 57.9 m ² . Nga ana tjetër, baza laboratorike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi. Fakulteti zotëron 4 laboratorë për lëndët dhe 7 laboratorë informatike, në total 641.5 m ² . Çdo salle informatike (laboratorë për informatikën) është e pajisur me hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve/seminareve dhe kompjuterët janë të pajisur me programe profesionale.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 77

FF

	<p><i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i> <i>Evidenca 42.1-2 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion FEUT_Struktura e teknologjisë së informacionit_Biblioteka</i> https://feut.edu.al/biblioteka/42-fondi-i-bibliotekes-se-feut</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>FEUT ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedise, me kushte të përshtatshme dhe të paisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, videoprojektor, si mundësi aksesimi të internetit (lidhje wireless), etj.</p> <p><i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i> <i>Evidenca 42.1-2 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion FEUT_Struktura e teknologjisë së informacionit_Biblioteka</i> <i>Vizitë e ambienteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave “Sisteme Informacioni në Ekonomi” realizimi i seancave të ushtrimeve, seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. GVJ konstatoi se nga ana e institucionit në përgjithësi dhe FEUT në veçanti i është kushtuar një vëmendje e veçantë paisjes me infrastrukturën e duhur informatike në mbështetje të programit. Kjo infrastrukturë informatike është e mbështetur dhe nga sisteme shfrytëzimi dhe programe kompjuterike që i korrespondojnë nivelit të kërkuar të formimit Master i Shkencave. Në DVV jepen të dhëna mbi karakteristikat e harduerit si dhe të programeve të karakterit të përgjithshëm dhe profesional të pranishëm në laboratorët përkatës dhe GVJ, gjatë vizitës së ambienteve, pati rastin të njihet me këta elementë.</p> <p>GVJ është i mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivat formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Evidenca 42 - Te dhena mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të paisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 78

natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>Evidenca: Vizita e ambienteve</i>		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>GVJ u informua se praktikat profesionale me studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" kryhen pranë subjekteve private e shtetërore sipas fushës së studimeve të studentit. Kjo mundësohet nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit me organizata dhe kompani të ndryshme që operojnë në vend, duke krijuar mundësi të mira për të kryer praktikën profesionale (e cila është parashikuar me një vëllim prej 12 kreditesh ECTS) në shërbim të përfundimit të eksperiencave praktike nga ana e studentëve. Gjithashtu, GVJ u informua se, praktikat profesionale kanë shërbyer për studentët edhe si mbështetje për realizimin e temave të diplomave si dhe një mundësi për punësim në këto kompani.</p> <p><i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022</i> <i>Evidenca 34.3 - Marrëveshjet e FEUT</i> <i>34.4 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se FEUT ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online. Biblioteka e FEUT ka një kapacitet prej 200 vendesh të ndara në dy sallat e studimit me 11 (njëmbëdhjet) kompjutera, të cilët janë të lidhur me bibliotekën online. Në ambientet e bibliotekës gjenden 70 tavolina të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj. Gjatë vizitës në bibliotekën e FEUT GVJ u njoh me ambientet e bibliotekës dhe procedurat e përdorimit të saj nga ana e studentëve. Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore në gjuhën shqipe të hartuar nga pedagogë të FEUT si edhe nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend. FEUT, ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të</p>

	<p>programeve të studimit. Studentëve u mundësohet dhe aksesimi në Bibliotekën Dixhitale U-Library nga RASH (https://ulibrary.rash.al/), që ka akses në EBSCO Publishing Databases.</p> <p><i>Evidenca 42.1-2 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion FEUT_Struktura e teknologjisë së informacionit_Biblioteka</i></p> <p><i>Evidenca 45.1 - Biblioteka-Lista e dokumentave per akreditim</i></p> <p><i>Evidenca 42.4 - Biblioteka-Manual_JSTOR</i></p> <p><i>Evidenca 42.4.2 - Manual Ulibrary</i></p> <p>https://feut.edu.al/biblioteka/42-fondi-i-bibliotekes-se-feut</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se biblioteka ka rreth 5280 tituj, nga të cilët rreth 2754 tituj në gjuhë të huaj. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje (https://feut.edu.al/biblioteka/42-fondi-i-bibliotekes-se-feut).</p> <p>Biblioteka përbëhet nga dy salla me një sipërfaqe totale prej 525 m² dhe një kapacitet prej 200 vendesh, ku 11 vende janë për përdorim kompjuteri për të mundësuar aksesimin në bibliotekën online.</p> <p><i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UT ka akses në bibliotekën digjitale JSTOR e mundësuar përmes bashkëpunimit me AADF. Kjo bibliotekë dixhitale ofron më se 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe mbi 2 milion dokumente në 75 disiplina. JSTOR është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Studentëve u mundësohet dhe aksesimi në Bibliotekën Dixhitale U-Library nga RASH (https://ulibrary.rash.al/), që ka akses në EBSCO Publishing Databases.</p> <p>Gjithashtu, biblioteka e FEUT është bërë pjesë e Programit Cobiss, duke mundësuar në këtë mënyrë qasje online në një numër të madh bazash të dhënash të bibliotekave të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca 42.4.1 - Biblioteka-University of Tirana 2020 IPA countersigned</i></p> <p>https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search</p> <p>https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/libraries</p> <p><i>Evidenca: Vizita në bibliotekë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me 11 kompjutera të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar në këtë mënyrë dhe aksesimin në bibliotekat online të cilat institucioni ka abonime.</p> <p><i>Evidenca: Vizita në bibliotekë.</i></p> <p><i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Referuar buxhetit të FEUT, për vitin 2021 në zërin Libra dhe publikime profesionale kanë qenë planifikuar 400 mijë lekë, duke pësuar një ulje në krahasim me vitin 2020 ku ky buxhet ka qenë 1500 mijë lekë.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e buxhetit dedikuar pasurimit të bibliotekës për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave që shtron përgatitja e studentëve me njohuritë më të avancuara të fushës si dhe puna kërkimore e personelit akademik dhe studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca 50.1.2 - Buxheti i miratuar 2020_4.11.1</i> <i>Evidenca 50.1.3 - Buxheti i miratuar 2021_4.11.2</i> <i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p>						
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka e FEUT e cila ndodhet në katin III të godinës A funksionon sipas orarit në vijim:</p> <p>E Hënë – E Premte 08:30 – 19:30; E Hënë – E Dielë 8:30 - 19:30 gjatë sezonit të provimeve;</p> <p>duke ofruar shërbimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Huazim i librave/teksteve. Studentët mund të regjistrohen duke paraqitur një vërtetim studenti, fotokopje të kartës së identitetit dhe një foto; - Sallë studimi; - Hapësirë për kryerjen e detyrave apo projekteve në grup. <p>GVJ është i mendimit se në këtë mënyrë funksionimi i bibliotekës (gjatë javës) përgjatë gjithë ditës si dhe gjatë sezoneve të provimeve edhe në fundjavë mundëson një përgjigje më të mirë ndaj numrit të madh të studentëve të FEUT.</p> <p>https://feut.edu.al/biblioteka <i>Vizita në bibliotekë</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në FEUT garantohet nga Rregulloret përkatëse. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Sistemi informatik i menaxhimit të informacionit (në momentin e vizitës në institucion) ka qenë akoma në proces upgrade-imi, pas një pezullimi për rreth 5 vjet. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër Rregjistrimit të arritjeve akademike dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Përsa i përket Rregjistrimit themeltar u konstatua se në momentin e vizitës, ky regjistër mbahej vetëm në format elektronik dhe jo në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p><i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perdituesar 2016</i> <i>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët</i> <i>Evidenca 46.2 - Rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik</i> http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut <i>Vizitë në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i informacionit i e-Student synon të kontribuojnë në menaxhimin e elementëve që lidhen me procesin mësimor (studentin dhe pedagogun). Ky sistem, i cili ka qenë pezullur për një periudhë 5 vjeçare, aktualisht është në proces upgrade-imi. GVJ është i mendimit se, megjithë përmirësimet e parashikuara, sistemi i informacionit i e-Student, kërkon përmirësime dhe plotësime të mëtejshme për të mundur menaxhimin e plotë të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><i>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët</i> <i>Vizita në institucion</i> http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Aksesi në sistemin e-Student mundësohet nëpërmjet adresës http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi u mundësohet pedagogëve të kontrollojnë grupet mësimore, të realizojnë hedhjen e notave për</p>

	<p>studentët, të kontrollojnë kërkesat e ardhura për përmirësim nga ana e studentëve si dhe të kontrollojnë kërkesat për ankimim vlerësimi të ardhura nga studentët. Studenti nga ana e tij mund të përdorë sistemin për të bërë regjistrimin për pjesëmarrjen në provime, për t'u njohur me rezultatet, etj. Sistemi informatik i menaxhimit të informacionit (në momentin e vizitës në institucion) ka qenë akoma në proces upgrade-imi, pas një pezullimi për rreth 5 vjet.</p> <p><i>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët</i> <i>Evidenca 46.1 - Upgrade i aplikimit software e-Student</i> <i>Evidenca 46.2 - Rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik</i> <i>Vizita në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, FEUT gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams janë zhvilluar seanca mësimore gjatë pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektësh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë stafi dhe studentët e FE janë të pajisur me adresa email-i zyrtare të formatit emer.mbiemer@unitir.edu.al duke u përdorur edhe kjo formë komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca: Takime në institucion</i> https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams/ https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/11/Microsoft-office-365-për-student.pdf <i>Evidenca 39.1 - Udhëzues i UT për zhvillimin e mësimin në distancë</i> <i>Evidenca 46.2 - Rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi e-Student mundëson hyrje e dedikuar të studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion është platforma Microsoft Teams, faqet zyrtare të UT dhe FEUT ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Por, GVJ është i mendimit se në stadin aktual sistemi e-Student nuk garanton plotësisht monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësimin e raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p><i>Evidenca 46.2 - Rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik</i></p>

	http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut <i>Vizita në institucion</i>		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UT si dhe faqes elektronike të FEUT, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit. Në faqen e FEUT jepet informacion dhe për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj. GVJ eksploroji mundësitë e ofruara për përfundimin e informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë. Megjithatë, ky informacion jepet vetëm në gjuhën shqipe. Ndërkohë, faqja e internetit e institucionit është aktive edhe në gjuhën angleze. https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/37-sisteme-informacioni-ne-ekonomi https://feut.edu.al/lajmerime https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-statistikes-dhe-informatikes-se-zbatuar/stafi-i-departamentit-siz https://unitir.edu.al/eng/cikli-i-ii-master-profesional/		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel njësie kryesore mbulohet nga Administratori i FEUT, ndërsa në nivel institucioni nga Administratori i UT dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin akademik dhe Rektorin e UT. Buxheti i UT-së alokohet sipas Njësive Kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. GVJ konstatoi se nuk ka një

	<p>detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UT (me të ardhura të konsiderueshme nga tarifat e studentëve dhe një numër të madh të të studentëve të rregjistruar) GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Evidenca 49.1 - RELACION_ Lënda-Mbi performancën financiare përperiudhën 12-mujore të vitit 2020 për UT-në</i></p> <p><i>Evidenca 50.1.5 - Raport financiar_UT_2020_2021_4.19</i></p> <p><i>Evidenca 50 - Te dhena nga plani financimit nga programi i studimit (tabele permbledhese)</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në Statutin përcaktohet se veprimtaria e UT financohet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; veprimtari kërkimore-shkencore; projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare. <p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjal administrativ UT-së i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregullore të UT-së. Me propozim të Senatit Akdemik ai miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm si edhe garanton zbatimin e tij. Ai përcakton edhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që sigurohen nga ushtrimi i veprimtarisë si edhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit. Në nivel institucioni autoriteti drejtues administrativ është Administratori i UT, ndërsa në nivel njësie kryesore është Administratori i FEUT. Akti më i rëndësishëm në lidhje me aspektet e menazhimit të institucionit është miratimi i Buxhetit të institucionit. GVJ konstatoi se procesi i hartimit të projekt buxhetit është gjithëpërfshirës dhe miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të UT-së. Projekt buxheti parashikon në mënyrë të detajuar sipas njësisve kryesore gjithë elementët përbërës të tij dhe hartohet mbi bazën e propozimeve të cilat e kanë burimin në nevojat e identifikuar nga Departamentet të pasqyruara në raportet e analizës vjetore të organizuara për analizën e ecurisë së programeve mësimore që mbulohen prej tyre.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p>

	<p>https://unitir.edu.al/struktura-organizative/ <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditesuar 2016</i> <i>Evidenca 50.1.3 - Buxheti i miratuar 2021_4.11.2</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të UT-së dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në strukturën administrative të UT është dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm me 7 punonjës, e cila ndër të tjera auditon përputhshmërinë, performancën, kryen auditimin financiar të të gjitha njësisve shpenzuese në UT-së, si dhe auditim të kombinuar që synon përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve të UT.</p> <p><i>Evidenca 50.1.7 - Program auditit_4.21</i> https://unitir.edu.al/struktura-organizative/ https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/Tabela_-_Raporti-i-Monitorimit-12-mujori-2020-MASR_removed.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>UT paraqet në MAS në fund të çdo viti akademik raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentura përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Sektori i Finances është përgjegjës për raportimin e realizimit të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Planifikimet dhe ndërhyrjet parashikohen në buxhetet afatmesme dhe ato synojnë garantimin e mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 50.1.5 - Raport financiar UT 2020_2021_4.19</i> <i>Evidenca 50.1.3 - Buxheti i miratuar 2021_4.11.2</i> https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/relacion-2020.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Universiteti i Tiranës dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në egzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 49.1 - RELACION Lënda-Mbi performancën financiare përperiudhën 12-mujore të vitit 2020 për UT-në</i> <i>Evidenca 50.1.5 - Raport financiar UT 2020_2021_4.19</i></p>

	Evidenca 50 - Te dhena nga plani financimit nga programi i studimit (tabele permbledhese) https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/plan-shpz-2020.pdf		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e UT, Rregulloren e UT, Rregulloren e Diplomimit, dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FEUT zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi. <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perditësuar 2016</i> <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Takime në institucion</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se DSIZ ndjek politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që garantojnë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 87

<p>të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>barazinë tek studentët në këtë program studimi. Statuti dhe rregulloret institucionale garantojnë mundësi të barabarta për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënies si edhe kërkimit shkencor. Procedurat e ndjekura janë në përputhje edhe me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore në fuqi të kërkuara edhe nga MAS. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga DSIZ dhe mbikqyret dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e Arsimit të Lartë, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit, format e mësimdhënies, kërkesat për pjesëmarrjen e studentëve në mësim, kontrollin e dijeve dhe sistemin e vlerësimit, organizimin e praktikave profesionale, mënyrën e diplomimit etj., i gjejmë të shprehura në Rregulloren e Programit të Studimit. Pjesërisht ato janë të pasqyruar në website të FEUT. Diplomimi i studentëve realizohet në përputhje me Rregulloren e Diplomimit dhe pajisja e studentit me diplomë sipas formatit të miratuar shoqërohet dhe me suplementin e diplomës. Të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE UT perdituesar 2016</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit MSHSIE</i> https://feut.edu.al/programet-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-sisteme-informacioni-ne-ekonomi <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik.</p> <p>Kriteret e pranimit, të cilat bëhen publike në faqen e internetit të FEUT janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diplomë Bachelor në Informatikë Ekonomike të Fakultetit të Ekonomisë, UT ose të fakulteteve të tjera në IAL (publike/jopublike–vendase/të huaja). • Diplomë Bachelor në Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Informatike dhe degë të tjera të ngjashme në fakultete të tjera të IAL (publike/jopublike–vendase/të huaja) mund të pranohen pasi të jetë kryer njohja e diplomave të tyre sipas rregulloreve përkatëse të Fakultetit të Ekonomisë, UT dhe pas plotësimit të njohurive të tyre formuese. <p>Elementë më të detajuar lidhur me pranimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit (Neni 10 – Pranimi i studentëve). Përzgjedhja e aplikantëve fitues kryhet nga një komision ad-hoc i</p>

ngritur nga Dekani i FEUT me propozim të DSIZ. Përzgjedhja kryhet mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit Bachelor. Elementët e tjerë që lidhen me vlerësimin e dijeve dhe diplomimin gjenden në rregulloren e programit të studimit. Referuar tabelës së mëposhtme, në tre vitet e pasqyruar, në këtë program studimi nuk ka patur transferime.

Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi"

Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2019-2020	50	-	50
2020-2021	52	-	52
2021-2022	58	-	58

Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE

<https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-sisteme-informacioni-ne-ekonomi>

Evidenca 47.2.1 - Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021_Cikli i II-të

RVB – Aneks – Tabela 21

Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.

Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit dhe procedurën për t'u ndjekur, jepen në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" dhe në Rregulloren e UT. Njoftimet shoqëruar me kriteret e pranimit janë të aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit të FEUT. GVJ konstatoi se nuk ka kritere specifike që lidhen me notën mesatare të ciklit Bachelor për pranimin në këtë program studimi. Megjithatë, konstatohet se nota mesatare në hyrje e aplikantëve është e lartë dhe varion nga 7.73 në vitin akademik 2019-2020 deri në 8.11 në vitin akademik 2021-2022, duke shënuar në këtë mënyrë një rritje të vazhdueshme.

<https://feut.edu.al/lajmerime/1834-vazhdojne-aplikimet-per-studimet-e-ciklit-te-dyte-master>

[https://drive.google.com/file/d/1w8gS_1-](https://drive.google.com/file/d/1w8gS_1-2UCzj7_T7KkRirD652nswEgA3/view?usp=sharing)

[2UCzj7_T7KkRirD652nswEgA3/view?usp=sharing](https://drive.google.com/file/d/1w8gS_1-2UCzj7_T7KkRirD652nswEgA3/view?usp=sharing)

Evidenca 07 - Rregullore e Programit të Studimit_MSHSIE

RVB – Aneks – Tabela 21

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun

Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar RVB dhe takimeve në

dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<p>institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Ekonomi.</p> <p>https://drive.google.com/file/d/1w8gS_1-2UCzj7_T7KkRirD652nswEgA3/view?usp=sharing</p> <p>RVB</p> <p>Takime në institucion</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" realizohet me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 2 vjet. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është mesatarisht 60 kredite (65 vitin e parë dhe 55 vitin e dytë). Studimet e këtij programi përmbillen me punim diplome. Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të FEUT. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi"; - Rregullorja e UT; - Rregullorja e Diplomimit. <p><i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE _UT_perditesuar_2016</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-sisteme-informacioni-ne-ekonomi <i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE</i> https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 90

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Neni 109 i Statutit të UT jep elementët që lidhen me transferimet dhe kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët apo kandidatët për studentë në këtë program studimi mund të njihen me këta elementë duke aksesuar statutin e UT nëpërmjet linkut: https://unitir.edu.al/4975f147-2ee0-43da-8933-8e57fdc04486</p> <p>Elementë shtesë jepen edhe në Rregulloren e UT (Neni 78 dhe 79). <i>Evidenca 05.1 - RRËGULLORE _UT_perditesuar_2016</i></p> <p>GVJ nuk pati rastin të njihet me ndonjë procedurë transferimesh, duke qenë se në tre vitet e fundit nuk ka patur studentë të transferuar, por vetëm dy studentë të çrregjistruar. <i>Vizita në Sekretarinë Mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit përftohet nëpërmjet Rregullores së FEUT dhe Rregullores së programit të studimit. GVJ u informua se elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse. <i>Evidenca 06.2 - Faculty of Economics, Regulation</i> <i>Evidenca 07 - Rregullore e Programit te Studimit_MSHSIE</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi". Në planin mësimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 18 kredite ECTS. Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në rregulloren e diplomimit dhe formatin e mikrotezës së ciklit të dytë të studimeve. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template. Studentët kanë akses në këtë informacion nëpërmjet faqes së internetit të FEUT. https://feut.edu.al/images/dokumenta-studentet/te-tjera/format_mikroteze_master_shkencor.doc <i>Evidenca shtesë nr 2.7-Plani mësimor korrigjuar-Tabela 10 dhe Tabela 11</i></p>


	<p><i>Evidenca 06.3 -Rregullore Diplomimi, FE</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-diplomimin-ne-ciklin-e-pare-te-dyte-dhe-te-trete-te-studimeve-master-ekzekutiv-ne-universitetin-e-tiranes/</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësisë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Gjithashtu faqja e internetit e FEUT (https://feut.edu.al) ofron një gamë të gjerë informacionesh në lidhje me kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional dhe planin mësimor të programit të studimit.</p> <p>https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-sisteme-informacioni-ne-ekonomi</p> <p><i>Takime në institucion</i> RVB</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, mbrojtje diplomash dhe praktikash mësimore etj., është i</p>

	<p>aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të FEUT. Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programet e studimit/lëndët përkatëse.</p> <p>https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/msc-ne-sisteme-informacioni-ne-ekonomi https://feut.edu.al/studentet/sherbime-studentore https://feut.edu.al/orari-mesimor-data-provimesh <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga shyrtimi i DVV, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GVJ u informua se FEUT shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit ku pasqyrohen Rregulloret dhe Statuti i institucionit si dhe një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit si dhe informacioni për numrin e krediteve dhe pedagogun përkatës të lëndës. Syllabuset që çdo pedadog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë.</p> <p>https://feut.edu.al/legjislacion/762-statuti-i-universitetit-te-tiranes https://feut.edu.al/legjislacion/1709-rregullore-e-universitetit-te-tiranes https://feut.edu.al/orari-mesimor-data-provimesh <i>Takim në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në organigramën e FEUT, në varësi të Zv.Dekanit për marrëdhëniet me sipërmarrjet dhe institucionet publike, është dhe një specialist i këshillimit të karrierës. Kjo ka mundësuar funksionimin e qendrës së karrierës. Qendra e Karrierës, pjesë e strukturës së Universitetit të Tiranës, filloi të funksionojë në vitin 2010. Zyra e parë e Qendrës së Karrierës u hap në Fakultetin e Ekonomisë me fillimin e vitit akademik Tetor 2012. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të Qendrës është dhe Panairi i Karrierës (i fundit i organizuar në prill 2022, ku morrën pjesë mbi 45 kompani), i cili jep mundësinë e zhvillimit të formës më bashkëkohore të rekrutimit. Ai shërben si një urë e drejtëpërdrejtë komunikimi mes tregut të punës dhe punëkërkuësve të ardhshëm (studentëve) nga çdo fushë studimi e UT. Ky aktivitet është frytdhënës për të dy palët, pasi Universiteti promovon studentët e tij dhe subjektet pjesëmarrëse rritin cilësisht burimet e tyre njerëzore. Zhvilluar në ambjentet e fakulteteve të UT, një numër i madh subjektësh vijnë me standat e tyre për të ofruar mundësi konkrete për</p>

	<p>studentët dhe alumnin e Universitetit (punësim, internship-e, trajnime, workshop-e, etj).</p> <p>Në faqen e internetit të FEUT në mënyrë të vazhdueshme publikohen njoftime për mundësi internship-i apo punësimi për studentët e FEUT. GVJ, nga takimi i zhvilluar me zyrën e karrierës së FEUT si dhe nga shqyrtimi i informacionit të DVV dhe faqes së internetit, është i mendimit se lidhja me biznesin është në nivele shumë të kënaqshme dhe se mbështetet fuqimisht orientimi i studentëve drejt dhe në tregun e punës.</p> <p>https://feut.edu.al/fakulteti/organigrama https://feut.edu.al/studentet/qendra-e-karrieres https://feut.edu.al/lajmerime <i>Takim më Zyrën e Karrierës</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik aksesohen nëpërmjet faqes së internetit të FEUT. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohen dhe formulara të ndryshëm si Formular miratimi i Praktikës Mësimore, Formulari i Vlerësimit të Studentit Praktikant, Raport mbi zhvillimin e praktikës mësimore, Format Mikroteze Masteri Shkencor etj. si dhe njoftime për bursa të ofruara nga shteti, bursa ndërkombëtare dhe bursa të ofruara nga Agjenci Kombëtare, tarifat e studimit etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore. GVJ e gjen një praktikë të tillë në përputhje me standartin.</p> <p>https://feut.edu.al/orari-mesimor-data-provimesh https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet https://feut.edu.al/studentet/mundesi-per-bursa https://feut.edu.al/studentet/tarifate-studimit <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ u informua se sistemi e-Student mundëson hyrje e dedikuar të studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion janë dhe faqet zyrtare të UT dhe FEUT ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, FEUT gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams. Nëpërmjet Microsoft Teams janë zhvilluar seanca</p>

17



	<p>mësimore gjatë pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektësh, njoftime, informacione etj.</p> <p>http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut</p> <p>Evidenca 46.1 - Upgrade i aplikimit software e-Student</p> <p>Evidenca 46.2 - Rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik</p> <p>Evidenca 3.4 Manual perdorimi Udhezues Microsoft Teams.</p>								
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit i cili administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve, i emërtuar e-Student aksesohet nëpërmjet adresës http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi u mundësohet pedagogëve të kontrollojnë grupet mësimore, të realizojnë hedhjen e notave për studentët, të kontrollojnë kërkesat e ardhura për përmirësim nga ana e studentëve si dhe të kontrollojnë kërkesat për ankimim vlerësimi të ardhura nga studentët. Studenti nga ana e tij mund të përdorë sistemin për të bërë regjistrimin për pjesëmarrjen në provime, për t'u njohur me rezultatet, etj. Sistemi informatik i menaxhimit të informacionit (në momentin e vizitës në institucion) ka qenë akoma në proces upgrade-imi, pas një pezullimi për rreth 5 vjet.</p> <p>Evidenca 46 - e-Student Manual Përdorimi për Pedagogët</p> <p>Evidenca 46.2 - Rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-informatik</p> <p>http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut</p> <p>Vizitë në sekretarinë mësimore</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbyhet pjesërisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht				X
	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore e FEUT është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave. Në programin e studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 95

në Ekonomi" në periudhën 2018-2022 janë diplomuar gjithsejt 117 studentë (prej të cilëve 31 studentë të diplomuar në vitin akademik 2020-2021).

Evidenca shtesë 1.1-MSHSIE-FEUT_Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve-Aneks Tabela 23

Vizitë në sekretarinë mësimore

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.

Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit. Rregjistrimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:

Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi"			
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2019-2020	50	-	50
2020-2021	52	-	52
2021-2022	58	-	58

Në Sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se Rregjistri themeltar në momentin e vizitës, ishte i disponueshëm vetëm në format elektronik dhe jo në formë fizike në rregjistrin e miratuar nga QSHA.

RVB – Aneks – Tabela 21

Vizitë në sekretarinë mësimore

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e studentëve. GVJ verifikoi në vizitën e kryer në sekretarinë mësimore rregjistrin e arritjeve akademike. Nga kontrolli i rregjistrin të arritjeve akademike, për një lëndë të zgjedhur rastësisht, rezultoi i hedhur në mënyrë korrekte. Frekuentimi ditor i lëndëve mbahet nga ana e pedagogëve respektivë dhe dorëzohet në Departament, ndërsa në sekretari dorëzohet proces-verbali final me këto të dhëna.

Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi

Vizitë në sekretarinë mësimore

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit të emërtuar *e-Student*. Për të garantuar sigurinë e informacionit, hyrja realizohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Sistemi informatik i menaxhimit të informacionit (në momentin e vizitës në institucion) ka qenë akoma në proces upgrade-imi, pas një pezullimi për rreth 5 vjet. Gjatë kësaj periudhe, informacioni në lidhje me studentin është hedhur manualisht dhe pasqyruar në rregjistrat përkatës (edhe në format elektronik) nga ana e Sekretarisë Mësimore.

http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut

Vizitë në sekretarinë mësimore

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve

Departamenti dhe Sekretaria Mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Qendra e Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik.

Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:

Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi"			
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Nota mesatare në hyrje	7.73	7.78	8.11

Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2018-2022 janë:

Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
117	84.4%	9.1%	6.5%

Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ

Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021

Evidenca shtesë 1.1-MSHSIE-FEUT_Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve-Aneks Tabela 23

Takime në institucion

RVB – Aneks – Tabela 21

Përmëshet

Përmëshet kryesisht

Përmëshet plotësisht

17.

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Neni 130 i Statutit të UT, përcakton funksionimin në institucion të Këshillave të Studentëve, si organizim i pavaruar i studentëve. Këshilli studentor i FEUT përbëhet nga 5 anëtarë (zgjedhur në dhjetor 2021). Gjithashtu, GVJ konstatoi se studentët, në përputhje me aktet ligjore dhe ato rregullatore të UT, janë të përfaqësuar në Senatën akademik, kanë përfaqësuesin e tyre në zyrën e NJSBC, marrin pjesë në Këshillin e Etikës, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës në UT.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> https://feut.edu.al/studentet/organizime-studentore https://unitir.edu.al/kizs-shpallja-e-rezultateve-te-zgjedhjeve-per-anetare-te-keshillave-studentor-te-fakulteteve-te-ut-se/ https://unitir.edu.al/komisioni-i-mbarevajtjes-se-veprimtarise-dhe-marredhenieve-me-studentet/ https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/01/20210106_093036.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UT dhe FEUT garantojnë përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, Këshillin e Etikës Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke mbajtur kontaktet me studentët dhe duke kontribuar në organizimin e një pyetsori për punësimin e studentëve si dhe mbi sugjerimet që mund të kishin në raport me kurrikulën. Përveç sa më sipër, studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të</p>

	<p>lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri si dhe në vlerësimin e praktikës mësimore nëpërmjet formularit përkatës.</p> <p>GVJ u informua mbi përpunimin e rezultateve të pyetsorëve dhe vënien në dispozicion si DSIZ ashtu edhe drejtuesve njësisë kryesore dhe Institucionit. Rezultatet reflektohen edhe në raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore dhe vijohet më pas me përcjelljen e tyre Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>Evidenca shtesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve – MSHSIE.</i></p> <p><i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p> <p><i>Takim me GVB</i></p>												
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se hartimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" është bërë në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë" dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" duke marrë në konsideratë që ngarkesa javore në auditor të mos kalojë 25 orë. Numri i orëve totale në auditor dhe për studim individual paraqitet si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="523 1075 1385 1332"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Orë në auditor</th> <th>Orë studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>I</td> <td>675</td> <td>950</td> </tr> <tr> <td>II</td> <td>555</td> <td>820</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>1230</td> <td>1770</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në rregulloren e UT (neni 79) parashikohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njejtit cikël studimi, brenda UT apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Në takimin me studentët u përmendën raste të njohjes së krediteve të përfuara gjatë mobiliteteve.</p> <p><i>Evidenca shtesë nr 2.7-Plani mësimor korrigjuar-Tabela 10 dhe Tabela 11</i></p> <p>https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/</p> <p><i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p>	Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	I	675	950	II	555	820	Total	1230	1770
Viti	Orë në auditor	Orë studim individual											
I	675	950											
II	555	820											
Total	1230	1770											
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të institucionit (Senat, NJSBC, Këshillin e Etikës Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Komisionin e</p>												

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 99

dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përhershëm të Kurrikulës si dhe në GVB). Gjithashtu, nëpërmjet pyetsorëve të studentëve tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësimin e mëtejshme. <i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave.</i> <i>Evidenca 40 - Pyetsorët e studentëve.</i>		
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. GVJ, bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konkludon se studentët kanë të drejtën e rivlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirëinformuar në këtë drejtim dhe se kishin patur raste të ballafaqimit me pedagogët përsa i përket vlerësimit, por që nuk kishin arritur deri në fazën e paraqitjes së ankimimit me shkrim. Nga takimi i GVJ me studentët, rezultoi që procedura realizohet në përputhje me rregulloren. https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/ <i>Evidenca: Takim me studentët</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Personeli akademik i DSIZ, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi", ka një aktivitet të spikatur kërkimor-shkencor. Vetëm gjatë vitit 2019-2020 në DSIZ janë mbrojtur 13 doktoratura, ndërsa numri i oponencave për të njëjtin vit ka qenë 24. Në mënyrë të përmbledhur pjesa thelbësore e aktivitetit kërkimor të DSIZ për 5 vitet e fundit paraqitet si vijon: <table border="1" data-bbox="507 1825 1332 1888"> <tr> <td>Botime nga personeli akademik efektiv</td> <td>109</td> </tr> </table>	Botime nga personeli akademik efektiv	109
Botime nga personeli akademik efektiv	109		

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 100

	<table border="1"> <tr> <td>Projekte kërkimore të fituara</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Projekte të zbatuara</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Aktivitete shkencore të organizuara për programin e studimit</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore</td> <td>32</td> </tr> </table> <p><i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ</i> <i>Evidenca 43 - Tabela 19_20_22-Te dhena per kerkimin shkencor ne 5 vitet e fundit DSIZ</i> <i>Evidenca 43.2.2 - Puna Kerkimore Shkencore 2019-2020_DSIZ</i></p>	Projekte kërkimore të fituara	5	Projekte të zbatuara	5	Aktivitete shkencore të organizuara për programin e studimit	8	Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	32
Projekte kërkimore të fituara	5								
Projekte të zbatuara	5								
Aktivitete shkencore të organizuara për programin e studimit	8								
Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	32								
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se UT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjes bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit të cilat kanë mundësuar aplikimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, konferencave shkencore si dhe i kanë shërbyer mobilitetit si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 34.3 - Marreveshjet e FEUT</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022</i> <i>Evidenca 34.4 - Marreveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023</i></p>								
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	<p>Cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi (nota mesatare në hyrje 8.11 për vitin akademik 2021-2022), krijon premisa për një angazhim cilësor të studentëve në veprimtari kërkimore dhe botuese. Referuar DVV, në tre vitet e fundit, 6 studentë janë aktivizuar në punimet shkencore të pedagogëve, ndërsa 10 studentë janë aktivizuar në projekte shkencore në rang Departamenti, ndërsa 30 studentë kanë marrë pjesë në aktivitetet e projektit të financuar nga AKKSHI "Ndërveprimi Universitet – Sipërmarrje si një instrument strategjik për transferimin reciprok të dijeve". Gjatë takimit në institucion me pedagogët, GVJ u informua se në mjaft raste, studentët për realizimin e temës së diplomës janë pjesë e projekteve të pedagogëve.</p> <p><i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021</i> <i>Evidenca 43 - Tabela 19_20_22-Te dhena per kerkimin shkencor ne 5 vitet e fundit DSIZ</i> <i>Evidencë: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p>								
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	<p>GVJ u informua se institucioni nxit personelin akademik dhe studentët për të publikuar në revista shkencore me faktor impakti. Aktiviteti botues i personelit akademik e dëshmon një gjë të tillë. Nga takimi me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe</p>								

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 101

	<p>Marrëdhëniet me Jashtë, GVJ u informua se institucioni po kontribon për mbulimin e një pjesë të fee-ve si për botimet në revista shkencore ndërkombëtare ashtu dhe pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare. Kjo mundësohet nëpërmjet një buxheti modest për departamentin në mbështetje të kërkimit shkencor (rreth 1 milion lekë në vit). Mbështetjes së publikimit në revista shkencore ndërkombëtare i shërbejnë dhe aktivitetet të cilat synojnë përmirësimin e kompetencave për shkrimin dhe botimin e artikujve në këto revista. Mund të përmendim këtu Webinar-in "How to write and publish an article. Elsevier Author Workshop".</p> <p><i>Evidenca 43.1.3 - Raporti vjetor 2020-2021 Pika 3.2-1_DSIZ</i> <i>Evidenca 43.2.3 - Puna kerkimore shkencore 2020-2021</i> https://unitir.edu.al/webinar-how-to-write-and-publish-an-article-elsevier-author-workshop/ <i>Evidencë: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Për të mundur nxitjen dhe motivimin e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" për t'u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitetet kërkimore, një rol të veçantë kanë punimet e diplomave, të cilat kontribuojnë për iniciimin e studentëve në kërkimin shkencor duke u bërë pjesë e punës kërkimore të personelit akademik. Gjatë takimit në institucion me pedagogët, GVJ u informua se në mjaft raste, studentët për realizimin e temës së diplomës janë pjesë e projekteve të pedagogëve. Megjithatë, në stadin aktual, nuk ka të pranishëm elementë të angazhimit në studime që mund të çojnë në patentimin e tyre.</p> <p><i>Evidencë: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i> <i>Evidenca 43.2.3 - Puna kerkimore shkencore 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e formimit për disiplinën përkatëse dhe se punimet e diplomave të realizuara në kuadër të programit të studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi", përmbajnë elementë të kërkimit shkencor duke qenë se ka raste kur elementë të temës së diplomës janë pjesë e projekteve të pedagogëve. Neni 5 i rregullores së diplomimit përcakton se udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe përpunimin e tyre. GVJ u informua se jo vetëm baza laboratorike kompjuterike e institucionit është në dispozicion të studentëve diplomantë, por ata duke qenë se janë pothuajse të gjithë të punësuar, shfrytëzojnë edhe infrastrukturën e biznesit apo institucionit ku janë të punësuar.</p>

	<p><i>Takime në institucion (me pedagogët, me studentët)</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-diplomimin-ne-ciklin-e-pare-te-dyte-dhe-te-trete-te-studimeve-master-ekzekutiv-ne-universitetin-e-tiranes/</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UT si institucion dhe FEUT si njësi kryesore kanë nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi si me institucione homologe ashtu dhe me biznese të ndryshme dhe institucione bankare në vend. GVJ konstatoi se këto marrëveshje i kanë shërbyer organizimit të aktiviteteve të përbashkëta si dhe në një masë të madhe kryerjes së praktikave mësimore dhe realizimit të temave të diplomave të studentëve të programit të studimit. Në mënyrë të vazhdueshme, në faqen e internetit të FEUT shfaqen lajmërimi për mundësi mobilitetesh të studentëve në institucionet me të cilat janë nënshkruar marrëveshje.</p> <p><i>Evidenca 34.3 - Marrëveshjet e FEUT</i> <i>Evidenca 32_34 - Marrëveshjet e bashkëpunimit 2022</i> <i>Evidenca 34.4 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit FEUT 2014-2023</i> https://feut.edu.al/lajmerime/1954-mundesit-internship-i-per-studentet-e-feut-prane-studio-auditimi-dhe-kontabiliteti https://feut.edu.al/lajmerime/1939-hapen-thirrjet-e-reja-per-aplikime-erasmus-2024</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Punimet e diplomave të realizuara në kuadër të programit të studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi", përmbajnë elementë të kërkimit shkencor duke qenë se ka raste kur elementë të temës së diplomës janë pjesë e projekteve në të cilët studentët janë të angazhuar nga ana e pedagogëve udhëheqës. Aftësimi të studentëve për zhvillimin e dhe implementimin e metodave të kërkimit i shërben dhe lënda "Metodave Kërkimi" (4.5 ETCS), ku ata marrin njohuritë e duhura për përgatitjen e punimeve shkencore. Gjithashtu, në FEUT ofrohet doktrata në "Shkenca Ekonomike", Nënfisha "Sisteme Informacioni në Ekonomi" e cila synon të thellojë dhe të pasurojë njohuritë teorike dhe praktike të doktorantëve në fushën e Sistemeve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 103

	<p>të Informacionit në Ekonomi dhe të formojë shkencëtarë të rinj për ndjekjen e një karriere të mëtejshme akademike. Nga 199 kandidatë të shpallur fitues në qershor 2022 për të ndjekur studimet e Ciklit të Tretë, Doktoratë në Shkencat Ekonomike, 21 i përkasin dy fushave të DSIZ ku 9 prej tyre i përkasin fushës Sisteme Informacioni në Ekonomi. Një kontigjent kaq i madh i doktorantëve krijon të gjitha premisat për zhvillimin e një aktiviteti të gjerë kërkimor me mundësinë edhe të aktivizimit të studentëve të Masterit të Shkencave.</p> <p><i>Evidenca shtesë nr 2.7-Plani mësimor korrigjuar-Tabela 10 dhe Tabela 11</i></p> <p>https://feut.edu.al/programe-studimi/cikli-i-iii-doktorature/programet-e-studimit-ne-doktorature/doktorature-ne-sisteme-informacioni-ne-ekonomi-2</p> <p>https://feut.edu.al/lajmerime/1567-fakulteti-i-ekonomise-ut-prezanton-kandidatet-fitues-per-te-ndjekur-studimet-e-ciklit-te-trete-doktorate-ne-shkencat-ekonomike</p> <p><i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>GVJ u informua për angazhimin e institucionit për përfshirjen e studiuesve të rinj në projektet kërkimore vendase dhe të huaj, ku institucioni është angazhuar. Kjo bëhet dhe më e aktuale në kushtet e 21 doktorantëve të shpallur fitues në fushat që mbulon DSIZ.</p> <p><i>Evidenca 43.3.3 - Permbledhje e projekteve FEUT Janar 2021</i></p> <p>https://feut.edu.al/lajmerime/1567-fakulteti-i-ekonomise-ut-prezanton-kandidatet-fitues-per-te-ndjekur-studimet-e-ciklit-te-trete-doktorate-ne-shkencat-ekonomike</p> <p><i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni synon angazhimin e ekspertëve të huaj në kuadër të programeve të bashkëpunimit. GVJ u informua për synimin e FEUT për të rritur shkëmbimet me universitete homologe përfshirë aplikimin në projekte të përbashkët kërkimorë dhe shkëmbimin e eksperiencave kërkimore. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe vizitat në FEUT i kërkuesve shkencorë të huaj. Për t'u përmendur është bashkëpunimi i fundit i muajit tetor 2022, ku një grup profesorësh dhe akademikësh të Universitetit të Poitiers, Francë, gjatë një periudhe një javore u angazhuan në leksione dhe shkëmbimin e eksperiencave me kolegët e tyre të FEUT. Universiteti i Poitiers dhe UT janë shpallur fitues të një projekti të ri Erasmus plus KA171, me buxhet mbi 1 milion euro, në kuadër të të cilit parashikohet rrije e bashkëpunimit dhe intensifikim i marrëdhënieve në fushën akademike, kërkimore dhe të projekteve.</p> <p><i>Evidenca 43.3.3 - Permbledhje e projekteve FEUT Janar 2021</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 104

	https://unitir.edu.al/tabele-pasqyre-mbi-projektet-aktive-ne-ut/ https://feut.edu.al/lajmerime/1857-nje-grup-profesoresh-te-universitetit-te-poitiers-france-ne-fakultetin-e-ekonomise		
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	GVJ konstatoi se politika në drejtim të mobiliteteve është e tillë që konstatohet një rritje e vazhdueshme e tyre. Studentët e FEUT janë të përfshirë në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ në mobilitete të zhvilluara në universite në Gjermani, Çeki, Suedi, Austri, Itali, Angli, Spanjë, Poloni, Greqi, Turqi, Luksemburg etj. <i>Evidenca 43.6 - Mobilitetet e studenteve</i> https://feut.edu.al/lajmerime/1939-hapen-thirrjet-e-reja-per-aplikime-erasmus-2024		
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Një praktikë me një zhvillim në rritje e konstatuar nga GVJ është dhe organizimi i leksioneve të hapura me studentët dhe stafin e FEUT nga ana e kërkuesve të huaj. Specifikisht në programin e studimit MSHSIE janë ftuar për mësimdhënie 4 profesorë të huaj. Krahas mobiliteteve të studentëve shqiptarë në universitete të huaja është zhvilluar, megjithëse në një masë më të vogël dhe mobiliteti i studentëve të huaj në FEUT. Në dy vitet e fundit 6 studentë të huaj kanë përfutur nga këto mobilitete. Mendohet që në kuadër të shtimit të programeve të studimit në gjuhën angleze të rritet më tej numri i studentëve të huaj që realizojnë mobilitete në FEUT. <i>Evidenca 43.4 Incoming students</i> RVB https://feut.edu.al/lajmerime/1449-profesori-gjerman-reiner-osbild-zhvillon-leksion-te-hapur-me-studentet-e-fakultetit-te-ekonomise https://feut.edu.al/lajmerime/1403-profesor-ronald-c-tsang-zhvillon-leksion-te-hapur-me-studentet-e-fe		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	GVJ konstatoi në FEUT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UT. Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë:

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 105

<p>ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Karrierës; • Kujdestari i studentëve; • Zyra e Shërbimeve; • Sekretaria mësimore/zyrat IT dhe sekretaria departamentit. <p><i>Evidenca 12 - Projekt Rregullore e Zyrës së Karrierës.</i> <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> https://feut.edu.al/studentet/sherbime-studentore https://feut.edu.al/studentet/qendra-e-karrieres</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan Kujdestari i Studentëve. Referuar Statutit të UT, Kujdestari i Studentëve i cili ka mandat 2-vjeçar, ka për mision përçimin e çdo problemi të studentëve tek autoritete përkatëse, sipas kompetencës së tyre. Çdo student, si gojarisht apo dhe me shkrim, i identifikuar apo në mënyrë anonime, ka të drejtë të vërë në lëvizje kujdestarin e studentëve, i cili detyrohet që të shënojë në një regjistër çdo shqetësim dhe zgjidhjen përkatëse që i është dhënë. GVJ konstatoi se një mjet i fuqishëm për informimin e studentëve është dhe faqja e internetit e FEUT e cila përditësohet rregullisht dhe që nga studentët informohen për një seri elementësh si njoftime për mobilitete, aplikime për bursa, trajnime, internship-e, webminare, trajnime, leksione të hapur etj.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> https://unitir.edu.al/njoftime/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ u informua për funksionimin në FEUT të Qendrës së Karrierës, zyra e së cilës u hap në Tetor 2012. Ndër aktivitetet të cilat mbulohen nga kjo qendër mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i shkollave Verore/Dimërore, takime të hapura, leksioneve të hapura, Bussines Trip etj; - Organizimi i trajnimeve, workshop-eve, - Organizimi i Panairit të Karrierës (i fundit i organizuar në prill 2022, ku morrën pjesë mbi 45 kompani); - Informacion në lidhje me mobilitetet dhe bursat e studimeve jashtë vendit, si edhe ndihmë përgjatë gjithë procesit të aplikimit, si edhe informacion mbi mbrojtjen e testeve të gjuhës angleze TOEFL dhe TOEIC; - Angazhim Vullnetar;

	<ul style="list-style-type: none"> - Mundësimi i internship-eve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët; - Mundësi Punësimi, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. <p>https://feut.edu.al/studentet/qendra-e-karrieres https://feut.edu.al/lajmerime <i>Takim më Zyrën e Karrierës</i></p>						
<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Qendra e Karrierës, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, synon edhe grumbullimin e informacionit që lidhet me të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe anketim i organizuar së fundmi për punësimin e studentëve të diplomuar. Nga ky anketim ka rezultuar se rreth 84.4% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën. Megjithatë GVJ konstatoi se kjo qendër akoma nuk ka një bazë të përditësuar të dhënash të studentëve të punësuar pas diplomimit nga ky program studimi, e cila duke u vënë në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse do të mundësonte një orientim më të mirë të studentëve dhe një vështrim më të plotë të autoriteteve drejtuese mbi efikasitetin e programit të studimit. GVJ u informua se nga ana e departamenteve ka përpjekje për grumbullimin e këtij informacioni, por koordinimi me zyrën e karrierës nuk ka funksionuar plotësisht. Zyra e karrierës e FEUT e ka pozicionuar këtë problematikë si një nga prioritetet e saj.</p> <p><i>Evidenca shtesë 1.1-MSHSIE-FEUT_Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve-Aneks Tabela 23</i> <i>Evidenca: Minuta Sistemi Infomacioni ne Ekonomi</i> <i>Takim më Zyrën e Karrierës</i> https://feut.edu.al/studentet/qendra-e-karrieres</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="534 1400 710 1489">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="710 1400 949 1489">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="949 1400 1173 1489">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="534 1489 710 1554"></td> <td data-bbox="710 1489 949 1554" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="949 1489 1173 1554"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

FF



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar Statutit, në UT është ngritur Komisioni i Përhershëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë (KPSSC), i cili bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. NJSBC e FEUT është një strukturë ndihmësakadematike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FEUT. Kjo njësi është në varësi të drejtuesit të FEUT - Dekanit të fakultetit dhe funksionon në bazë të rregullores përkatëse.</p> <p>NJSBC pranë Fakultetit të Ekonomisë është një strukturë e re e krijuar në Tetor 2021. Gjatë vizitave në institucion GVJ-së iu referua që kjo njësi ka 8 anëtarë në përbërjen e saj, 6 (gjashtë) anëtarë prej së cilës janë staf akademik i brendshëm pranë – 1(një) për secilin Departament, 1 (një) anëtar i NJSBC dhe 1 (një) student.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës (KREUX)</i> https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/01/20210106_093036.pdf</p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesise.</i> <i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC</i> <i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise-</i> <i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët. Funksionimi i sistemit të sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse. Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet. Në këtë Njësi përfshihen personel akademik i brendshëm i Universitetit si edhe ekspertë të jashtëm dhe 1 student. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies,</p>

FR

[Signature]

	<p>vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetsorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj.</p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë.</i> <i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” është liçensuar përmes vendimit të Urdhërit të MASH nr.510 datë 8.11.2010 dhe vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. UT bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë dhe GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me NJSBC evidentoi zhvillimin e anketimeve me studentët në trajtën e pyetsorëve dhe transmetimin e informacionit te drejtuesja Departamentit. <i>Megjithatë GVJ konstatoi se nuk ka patur hartim raportesh të vlerësimit për programin e studimit shoqëruar me analizë, ku të integrohen rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik në nivel departamenti si dhe nuk është operuar me nxjerrjen e konkluzioneve të pasqyruar në raporte si dhe me plan aksioni për të adresuar problematikën e konstatuar. Në dokumentacion (Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve - MSHSIE), evidentohet se ka një raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetësorëve të studentëve, por në fakt ky raport është thjesht një informacion përshkrues.</i></p> <p><i>Në këtë mënyrë, GVJ sugjeron përdorimin e këtyre instrumentave dhe nxjerrjen e rezultateve konkrete si edhe masat në varësi të rezultateve.</i></p> <p>https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-27-tetor-2018</p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë.</i> <i>Evidenca shitesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve – MSHSIE.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Bazuar në evidencat përkatëse dhe nga takimet gjatë vizitës në institucion, UT ka hartuar politika të qarta dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme me qëllim</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 109

që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit

përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Përmirësimi i cilësisë është parë me prioritet edhe nga DSIZ duke mundësuar së pari përputhshmërinë e planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve me detyrimet ligjore në kuadër të rritjes së cilësisë në arsimin e lartë si dhe për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave të tregut dhe avancimeve bashkohore në këtë fushë. Në planin strategjik të DSIZ, ku paraqitet si qëllim i Departamentit ofrimi i kurrikulave cilësore në mënyrë që të sigurohet qasja ndaj tregut me profesionistët më të kualifikuar në hapësirën mbarëshqiptare e më gjerë, përcaktohen si prioritete dhe iniciativë kryesore:

- Zhvillimi i kurrikulës i bazuar në monitorimin e vazhdueshëm të eksperiencave më të mira ndërkombëtare, universiteteve dhe institucioneve që ofrojnë standartet më të mira në tregun ndërkombëtar, por edhe në anketimet periodike tek bizneset, organizatat publike, studimet e tregut të punës për të identifikuar situatën në treg me të diplomuarit;
 - Monitorim i ndryshimit të kurrikulës së departamentit SIZ nga universitetet që departamenti përdor si pikë referimi;
 - Vlerësimi në mënyrë të vazhdueshme i cilësisë së kurrikulës nga pikëpamja e strukturës dhe përmbajtjes së saj, për t'u siguruar që të diplomuarit të marrin njohuritë e domosdoshme për të plotësuar kërkesat e mjedisit të biznesit, si edhe aftësi kërkimore shkencore dhe personale. Kurrikulat e departamentit do t'i nënshtrohen një përmirësimi periodik të vazhdueshëm në mënyrë që t'ju shërbejnë sa më mirë organizatave publike dhe private por edhe sfidave të ekonomisë në tërësi;
 - Sigurimi i rritjes profesionale dhe mundësive të zhvillimit të studentëve nëpërmjet intemshipeve, prezantimeve, projekteve të drejtuara nga departamenti dhe diskutimeve të nxitura nga profesionistët e fushës;
 - Realizimi i anketimeve periodike tek studentët për të identifikuar përmirësimet e mundshme të kurrikulave që do të nxisin jo vetëm rritjen e numrit të studentëve aplikantë, por gjithashtu do të rritnin cilësinë e studentëve në hyrje e në dalje;
 - Nxitja e përdorimit të metodave bashkëkohore në mësimdhënie.
- GVI, në përmbajtje të të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk gjeti ndonjë praktikë konkrete të realizuar nga***

	<p><i>NJSBC me impakt në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Kështu, GVJ, duke qenë se NJSBC në FEUT, është një strukturë e re, sygjeron të qenit më prezent të saj, me plan veprimi konkret dhe të aktualizuar në sigurimin e cilësisë në të gjithë komponentët e sipërpërmendur.</i></p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë</i> <i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT</i> <i>Evidenca 04.1 - Plani strategjik i departamentit DSIZ</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja, rishikimi i programeve të studimit dhe në veçanti i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” mundësohet kryesisht nëpërmjet katër strukturave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë (KPSSC) në UT; - Komisioni i përhershëm i kurrikulës; - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë FEUT; - Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. <p>Secila prej strukturave të mësipërme operon në bazë të detyrave specifike që i përkasin nivelit të hierarkisë, ndërsa vetë menaxhimi i programit të studimit mbulohet nga Departamenti. Me ngritjen e NJSBC në nivel Fakulteti nevojitet një koordinim më i mirë ndërmjet DSIZ dhe kësaj strukture me qëllim që të mund të operohet më me efektivitet për mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë</i> <i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Mbikëqyrja e programit të studimit Master i Shkencave në “Sisteme Informacioni në Ekonomi” bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetsorëve që plotësohen dy herë në vit para përfundimit të semestrit e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 111

<p>herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>personelit akademik. Departamentet në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë hartojnë planin për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë. GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.</p> <p><i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT</i> <i>Evidenca 40 - Pyetsorët e studentëve</i> <i>Evidenca 41 - Pyetsorët e pedagogëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë. Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i lëndës nga studenti (<i>plotësohet nga çdo student përpara provimit të lëndës</i>) 2. Vlerësimi i studentëve që diplomohen (<i>plotësohet nga studentët para se të marrin diplomën</i>) 3. Vlerësimi për pedagogun (<i>plotësohet nga studenti përpara zhvillimit të provimit</i>) 4. Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (<i>plotësohet nga çdo pedagog pas përfundimit të lëndës</i>) 5. Formulari i vlerësimit nga personeli akademik (<i>plotësohet në fund të çdo viti akademik nga çdo pedagog i fakultetit</i>) 6. Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut (<i>plotësohet online nga pedagogu në platformën Microsoft Teams</i>) <p><i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave</i> <i>Evidenca 40 - Pyetsorët e studentëve</i> <i>Evidenca 41 - Pyetsorët e pedagogëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve nëpërmjet pyetsorëve përpunohen nga NJSBC dhe i vihen në dispozicion si DSIZ ashtu edhe drejtuesve njësisë kryesore dhe Institucionit. Rezultatet reflektohen edhe në raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore dhe vijohet më pas me përcjelljen e tyre Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>Evidenca shtesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve – MSHSIE</i> <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Në raportet vjetore të Departamenti, njësisë kryesore dhe Institucionit dhe në raportin e NJSBC përfshijnë vetëm rezultatet e vlerësimit por <i>GVJ sugjeron se në to duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasiorë dhe të adresohen masat e marra për problematikat e ndryshme të evidentuara.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 112

	<i>Evidenca shitesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve – MSHSIE</i> <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021</i> <i>Takime në institucion</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Elementë të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit mundësohen nga pyetsori i vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, proces i cili drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Një burim tjetër që mundëson krijimin e tabloje më të plotë për ecurinë e programit të studimit dhe respektimin e standarteve të cilësisë, është vlerësimi i programit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ky proces shoqërohet nga hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe plotësimi i Dosjes së Vetvlerësimit. Konkluzionet dhe analiza e realizuar në RVB përbëjnë një bazë të mirë nga e cila mund të nisët institucioni për përmirësimin e programit. GVJ gjatë takimit me anëtarët e GVB dhe konstatoi se hartimi i RVB është realizuar përmes shfrytëzimit të një informacioni të gjerë dhe bashkëpunimit me strukturat në gjitha nivelet.</p> <p>Gjithashtu, DSIZ realizon në mënyrë periodike analizë të aktivitetit të tij duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në Departament, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme.</p> <p><i>Evidenca 40 - Pyetsorët e studentëve</i> <i>Takim me GVB</i> <i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me</p>	<p>Procesi i vlerësimit të brendshëm në institucion bazohet në Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e UT dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 113

<p>natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Manualin e Cilësisë të UT. Mbi këtë bazë përdoren një sërë pyetsorësh (shih më sipër) plotësimi i të cilëve menaxhohet nga NJSBC. Në këtë aspekt rëndësi të veçantë merr dhe vlerësim i studentëve që diplomohen dhe raporti i studentëve, duke qenë se mundësojnë përfitim të një informacioni përfundimtar mbi gjithë programin e studimit duke përfshirë gjithë elementët e tij. Veç këtyre, një informacion i vlefshëm tërhiqet edhe gjatë hartimit të raporteve vjetore për MAS, studime për tregun e punës etj.</p> <p><i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave</i> <i>Evidenca 17 - Studimi i tregut të punës final</i> <i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ</i> <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga FEUT dhe DSIZ në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet e përgjegjësës të departamenteve me studentët e programeve të studimit, komunikimin me studentët ALUMI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testeve dhe ecurisë gjatë vitit akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë, vlerësimin e praktikës, etj.</p> <p><i>Evidenca 38 - Analiza vjetore e DSIZ</i> <i>Evidenca 37.3 - Raporti Vjetor FEUT 2020-2021</i> <i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (pjesë e GVB); - këshillohen me stafin akademik dhe përgjegjësën e departamentit si edhe përdorin zyrat mbështetëse për këtë qëllim; - kanë formuar Këshillin Studentor; - Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në zyrën e NJSBC; - marrin pjesë në Senatën Akademik; - marrin pjesë në Këshillin e Etikës. <p>Në procesin e vlerësimit kontribuojnë zhvillimi i anketimeve</p>

	<p>nëpërmjet pyetsoreve të studentëve, mbledhjes së të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmërinë etj., gjurmimit të studentëve të diplomuar, kontaktet me kompanitë e biznesit, studime në lidhje me tendencat e tregut të punës etj.</p> <p><i>GVJ, duke ju referuar nevojës së përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, sugjeron aplikimin e planeve të veprimeve në rast të evidentimit të problematikave apo edhe të nevojës së përhapjes së eksperiencës më të mirë.</i></p> <p><i>Evidenca RVB_Shqip;</i> <i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 05.1 - RREGULLORE_UT_perditesuar_2016</i> <i>Evidenca 08.3 - UT-Paketa e instrumentave</i> <i>Evidenca 17 - Studimi i tregut te punes_final</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka hartuar standardet për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit nga NJSBC me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përftuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 08.2 - UT-Manual i sigurimit te cilesise-</i> <i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë</i> <i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC</i> <i>Evidenca 43.5 - Mobilitetet e stafit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara</p>	<p>Rregullorja e NJSBC-së përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 115

<p>në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar është njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit dhe njëkohësisht dhe për garantimin e cilësisë së programit. Rregullorja e insitucionit, Rregullorja e FEUT dhe Rregullorja e NJSBC, parashikojnë angazhimin e anëtarëve te personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ si dhe studentëve të programit të studimit në vlerësimin e cilësisë. Nga takimi me GVB, u konstatua se për hartimin e RVB dhe plotësimin e DVV ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit.</p> <p><i>Evidenca 08 - UT-Rregullore për sigurimin e cilesisë.</i> <i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC</i> <i>Takim me GVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, në veprimtarinë e saj, NJSBC mbështetet edhe nga institucioni në përgjithësi si dhe nga FEUT dhe Departamenti Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar në veçanti. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p> <p>GVJ, bazuar në dokumentat e vënë në dispozicion nga Institucioni, konkretisht në Statutin e Institucionit dhe Kodin e Etikës, eidenton theksin që Institucioni vendos në parimin e barazisë kundrejt studentëve, stafit akademik dhe ndihmës akademik, por gjithashtu thekson edhe respektimin e integritetit akademik.</p> <p><i>Evidenca 02 - Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 02.1 - Draft-kodi i etikës UT</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të</p>	<p>UT në nivel fakulteti si edhe Departamenti, ka mundësuar tërheqjen në mënyrë joformale të mendimit mbi cilësinë e përgatitjes së studentëve nëpërmjet takimeve me aktorë të biznesit. Duke qenë se pjesa më e madhe e studentëve të programit të studimit janë të punësuar, një kontribut jo të vogël në elementë që lidhen me programin e studimit japin edhe vetë studentët në kuadër të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 116

vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	<p>pyetsorëve që plotësojnë. Në këtë aspekt rëndësi të veçantë merr vlerësimi i studentëve që diplomohen dhe raporti i studentëve, duke qenë se mundësojnë përfundimin e një informacioni përfundimtar mbi gjithë programin e studimit duke përfshirë gjithë elementët e tij ndikuar dhe nga ballafaqimi i tyre me tregun e punës e kërkesat e tij.</p> <p><i>Evidenca shtesë 1.2-MSHSIE-FEUT_Anketimi i të diplomuarve Korrik 2022</i></p> <p><i>Evidenca shtesë nr. 1.3-Studimi i tregut të punës UT_2022</i></p> <p><i>Evidenca 17 - Studimi i tregut te punes_final</i></p> <p><i>Evidenca shtesë 1.1-MSHSIE-FEUT_Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve-Aneks Tabela 23</i></p> <p><i>Takime në institucion</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Insitucioni zhvillon pyetësorë me studentët për vlerësimin e moduleve në fund të çdo semestri sikurse edhe të stafit akademik dhe ndihmës akademik. Rezultatet e pyetsorëve, sikurse përmendet edhe në rregulloren e NJSBC, i vihen në dispozicion drejtuesve të insitucionit si edhe vetë anëtarëve të stafit akademik. Ato diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe merren masat e nevojshme në rast problematikash.</p> <p><i>Evidenca shtesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve - MSHSIE</i></p> <p><i>Evidenca 08.0 - FEUT-Rregullore per sigurimin e cilesie NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon te gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Më pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin akademik rreth rezultateve të anketimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 08.4 - Miratimi i planit NJSBC FEUT</i></p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 117




	<p><i>Evidenca shtesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve - MSHSIE</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pas përpunimit të rezultateve të vlerësimit, NJSBC harton një raport i cili përcillet tek njësitë bazë. Megjithatë duhet theksuar se raporti përmban konkluzione për elementët e trajtuar nga pyetsorët përkatës, por përgjithësisht nuk jep rekomandime për adresimin e problematikave, duke u a lënë këtë aspekt instancave të tjera (Departamentit, FEUT, UT). Në këtë mënyrë, raportet e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit për t'u reflektuar në vendimmarrje konkrete prej tyre.</p> <p><i>Evidenca shtesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve - MSHSIE</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC menaxhon procesin e plotësimit të pyetsorëve dhe realizon përpunimin e informacionit të përfutur në trajtën e raporteve vjetore. Gjithashtu rezultatet u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Një analizë më specifike e problematikave të konstatuara dhe marrjen e masave për adresimin e tyre zhvillohet në nivel departamenti.</p> <p>Në global, GVJ konstaton përpjekje nga ana e UT në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që institucioni i jep këtij procesi.</p> <p><i>Evidenca shtesë 6-Raport mbi realizimin dhe përpunimin e pyetsorëve të studentëve - MSHSIE</i></p> <p><i>Takime në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Universiteti i Tiranës i kushton rëndësi trajnimit të stafit për përmirësimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies. Në këtë aspekt është mundësuar trajnimi i pedagogëve të rinj duke i ndihmuar ata në këtë mënyrë jo vetëm me metodat e mësimdhënies por me një tërësi elementësh që kanë të bëjnë edhe me sigurimin e cilësisë. Me impakt të konsiderueshëm në këtë drejtim ka qenë dhe një trajnim intensiv në fushën e pedagogjisë dhe mësimdhënies i 48 pedagogëve efektivë që kanë nisur punën rishtazi si personel akademik kohë të plotë pranë FEUT. GVJ u informua se në UT është ngritur që prej vitit 2021 "Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe trajnimit" Kjo qendër organizon në mënyrë periodike trajnime apo seminare të ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave dhe përfuturit të elementëve me interes si në drejtim të kualifikimit individual ashtu edhe në drejtim të marrjes së informacioneve për</p>

çështje të caktuara.
 Gjithashtu, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të FEUT, njësia përgjegjëse për programin e studimit si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Në këtë mënyrë, nga një analizë e thelluar e programit të studimit, është mundësuar evidentimi i pikave të forta, dobësive, kërcënimeve dhe janë paraqitur mundësitë që paraqiten para studentëve të këtij programi.

Evidenca 03.1 - Strategjia per planin institucional per mesimdhenie ne UT

<https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/>

Takim me Dekanin e FEUT

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		
	plotësisht	kryesisht	plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet		
	plotësisht	kryesisht	plotësisht
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Sisteme Informacioni në Ekonomi" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Tiranës"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Pjesa më e madhe e personelit akademik efektiv i DSIZ është me tituj e grada dhe me përvojë të madhe në fushat respektive të ekspertizës;
2. Pjesëmarrje e gjerë në nivel Institucioni si edhe Departamenti në thirrjet për projekte si Erasmus+, Horizon 2020, Jean Monet, projekte të financuara nga AKKSHI, AUF, etj.;
3. Investimi dhe përkushtimi në nivel Institucional për trajnimin e stafit të ri akademik nëpërmjet krijimit të "Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimin", duke organizuar në mënyrë periodike trajnime apo seminare të ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave dhe përfundimit të elementëve me interes si në drejtim të kualifikimit individual ashtu edhe në drejtim të marrjes së informacioneve për çështje të caktuara;
4. Cilësia por edhe numri i studenteve që zgjedhin programin e studimit Master i Shkencave në "Sisteme Informacioni në Ekonomi" është në rritje;
5. Punësimi i të diplomuarve në MSc në Sistemet e Informacionit në Ekonomi është 100%, madje ky punësim rezulton të jetë para apo gjatë periudhës së studimeve;
6. Angazhimi i dhe përfshirja e studentëve për pjesëmarrje në punimet shkencore, në projektet shkencore si edhe në aktivitetet e organizuara në kuadër të projekteve;
7. DSIZ ka vendosur si prioritet realizimin e kërkimit në funksion të syllabuseve të lëndëve që mbulon stafi i angazhuar në programin e studimit;
8. Përdorimi dhe shfrytëzimi i internetit, bën të mundur që një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, mbrojtje diplomash dhe praktikash mësimore etj., të jetë i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të FEUT, duke lehtësuar dhe duke u ardhur në ndihmë studentëve.

Pika të dobta

1. Personeli akademik me kohë të plotë është i mbingarkuar me orë mësimore dhe kjo ul kohën në dispozicion të kërkimit dhe ndërkombëtarizimit. **(Standardi I.2, kriteri 1)**

Rekomandime

1. Rritje e numrit të personelit akademik me kohë të plotë, duke qenë se ngarkesa mësimore e stafit aktual me kohë të plotë është shumë e lartë;
2. Ulje e numrit të personelit akademik me kontratë të angazhuar në këtë program studimi;

3. Duke qenë se NJSBC në FEUT, është një strukturë e re, sugjerohet të qenit e saj sa më prezente, me plan veprimi konkret dhe të aktualizuar, për sigurimin e cilësisë në të gjithë komponentët që lidhen me realizimin e programit të studimit;
4. Duke qenë se në stadin aktual sistemi e-Student nuk garanton plotësisht monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësimin e raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët, të ndërmerren hapat e duhur për vënien e tij në efikasitet;
5. Mbajtja nga Qendra e Karrierës e një baze të përditësuar të dhënash të studentëve të punësuar pas diplomimit nga ky program studimi, e cila duke u vënë në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse do të mundësonte një orientim më të mirë të studentëve dhe një vështrim më të plotë të autoriteteve drejtuese mbi efikasitetin e programit të studimit;
6. Angazhimi i partnerëve të tregut të punës nëpërmjet një procesi të strukturuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit;
7. Sygjerohet që të hartohet programi (syllabusi) i praktikës profesionale për këtë program studimi. Kjo do të ndihmojë studentët për të qenë më të qartë dhe të orientuar në realizimin e objektivave të saj.

**Conclusions of the evaluation of the second cycle program Master of Science
“Information Systems in Economics” offered by the Higher Education
Institution “University of Tirana”**

Strengths and affirmations

1. Most of the full-time academic staff of the Department of Statistics and Applied Informatics have academic degrees and titles as well as extensive experience in the respective fields of expertise;
2. Wide participation both at institutional and department level in calls for projects such as Erasmus+, Horizon 2020, Jean Monet, projects funded by AKKSHI, AUF, etc.
3. Investment and commitment at the institutional level for the training of new academic staff through the creation of the "Virtual Center for Professional Development and Training", periodically organizing various training courses or seminars at the service of increasing skills and obtaining elements of interest both in terms of individual qualification and in terms of receiving information on certain issues;
4. The quality but also the number of students who choose the study program Master of Science in "Information Systems in Economics" is increasing;

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 121


5. The employment of graduates in MSc in "Information Systems in Economics" is 100%, even this employment happens to be before or during the period of study;
6. Commitment and involvement of students for participation in scientific works, scientific projects as well as in activities organized within the framework of the projects;
7. The Department of Statistics and Applied Informatics has set as a priority the realization of research in function of the syllabuses of the subjects covered by the staff involved in the study program;
8. The use of the internet allows access via the FEUT website to a lot of the information, such as the teaching schedule, teaching structure, exam dates, consultations, the defense of diplomas, professional practices, etc., by facilitating information and supporting students.

Weakness:

1. Full-time academic staff are overloaded with teaching hours, and this reduces the time available for research and internationalization. (**Standard I.2, Criteria 1**)

Recommendations:

1. Increasing the number of full-time academic staff, since the teaching load of the current full-time staff is very high;
2. Reduction of the number of invited academic staff involved in this study program;
3. Given that the Internal quality assurance unit in FEUT is a new structure, it is suggested that it be as present as possible, with a concrete and updated action plan, for quality assurance in all components related to the realization of the study programme;
4. Given that at the current stage, the e-Student system does not fully guarantee real-time monitoring of academic and administrative activity and the possibility of individual reports and real-time data for governing bodies and holders, appropriate measures should be taken to implement it effectively;
5. Keeping by the Career Center of an up-to-date data base of students employed after graduation from this study program, which by being made available to students and relevant governing authorities, would enable a better orientation of students and a more comprehensive view of the governing authorities on the effectiveness of the study program;
6. Engagement of labor market partners through a structured process in the continuous improvement of the quality of the study program as well as the definition of a real methodology for identifying current and future skills directly linked to the study program.
7. It is suggested that the Department draft the syllabus of professional practice for this study program. This will help students to be clearer and well oriented towards achieving their goals.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHKËTTJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X